participatory process and stakeholder involvement, assessment of the current situation, identification of potential waste management schemes, cost calculation and cost recovery scenarios, discussions and evaluations, elaboration of the final waste management plan, and drawing up the plan and the supporting working documents.



OBJECTIVES AND PERFORMANCE INDICATORS

OBJECTIVE 1

To assess the existing situation

Performance
indicator


- ❖ Two meetings were held with the working group to initiate the participatory process and gather useful information (general and technical data); to review the commune's organization and staff, legal framework, and existing rules and regulations; and to identify financial management procedures related to waste management;
- ❖ A field visit was held to monitor the existing situation and to inquire into the possibility of developing future waste collection schemes.

OBJECTIVE 2

To provide effective solid waste management schemes, to select the most realistic scenario, and to finalize full service cost calculations and cost recovery options according to the pre-selected scenarios

Performance
indicator

- ❖ A meeting with the working group was held to develop and discuss the proposed scenarios;
- ❖ A meeting was held with the commune staff and a SDC expert to evaluate the potential scenarios and select a preferred one;
- ❖ The commune staff was assisted in conducting and evaluating cost and tariff analysis;
- ❖ Definition of the cleaning service tariff;
- ❖ Full cost accounting and cost recovery analysis were performed for each scenario, including full methodology, Excel files, maps, reports, etc.





OBJECTIVE 3

To elaborate and finalize a final waste management plan and to provide supporting documents for its implementation

Performance indicator	❖ A final waste management plan was elaborated, with findings, conclusions, and recommendations in the following areas: ❖ Institutional and regulatory aspects: The proposed UWM organizational structure of the commune, communal regulation and tools related to WM, potential institutional partnerships and coordinated interventions; ❖ Operations/Technical targets: Recommendations for improving the proposed schemes, identifying and promoting recycling initiatives, practicing composting, ❖ waste disposal; ❖ Plan for financing waste collection scheme, identification of financial resources and economic benefits: Identification of financial resources and cost recovery for the short-, mid-, and long-term plans, measures proposed to improve fee structure in gaining financial sustainability; ❖ Plan for public awareness and education/ PP partnerships; ❖ Plan for monitoring and evaluating the proposed scheme; ❖ An action plan for 2010-2014 for UWM plan implementation; ❖ A short report on the legal, regulatory, and organizational framework for solid waste management in Dajç included as part of the action plan
-----------------------	---

OBJECTIVE 4

To increase capacity-building for the team of Commune of Dajç by developing the plan and by participating and pursuing the implementation of SWMP in Guri i Zi

Performance indicator	❖ In all meetings with the working group, the staff of Commune was provided with knowledge and practical assistance on how to proceed with all waste management planning and implementation processes; ❖ The staff of the commune of Dajç also participated in the implementation process of SWMP in Guri i Zi
-----------------------	---

Follow-up technical assistance for SWMP implementation in the Commune of Guri i Zi

Implementation period: September 2009 - December 2009

Donor: Inter-Cooperation in Albania

Fund: 11,525 €

Implemented in: Commune of Guri i Zi

The approved Solid Waste Management Plan (2009) for the Commune of Guri i Zi provided guidelines for an effective waste collection scheme in accordance with the commune's capacities and benefiting the local community. The commune requested additional technical assistance in the implementation of SWMP and the preparation of supporting documents. After approval of the plan, the commune chose the first scenario as the best service provision option. The plan called for a garbage truck, provision of new waste





and final disposal at an existing dumpsite in Shkoder.

According to the preferred scenario, waste collection services were to be offered to the pilot area of Guri i Zi, Juban, Vukatanë, and Rrenc, and to businesses and institutions in the villages Rragam, Ganjoll, and Gajtan. The implementation of the project took place in Commune of Guri i Zi.

Based on the recommendations in the SWMP document and the needs presented by the commune, the project

aimed to enable local authorities to put into practice effective and efficient waste management services in the commune.

The project proceeded by mobilizing a previously established working group and followed by evaluating and revising the waste collection scheme and further developing cost calculations, a project budget, and a proposed cost recovery system, and by preparing supporting documents and technical assistance in order to successfully initiate waste management.



OBJECTIVES AND PERFORMANCE INDICATORS

OBJECTIVE 1

To assist the commune in improving its chosen waste collection scheme, calculating annual costs, planning investments, and financing and implementing the waste collection project

Performance indicator


- ❖ A meeting was held to organize the commune's existing working group, to gather additional information, and to discuss and cooperate with Co-PLAN experts regarding the provision of necessary documentation and skills related to waste collection and implementation of the management scheme in the commune;
- ❖ Field visits were undertaken to each of the villages of the commune with participation by commune and community representatives in order to verify the proposed waste collection scheme, to identify waste collection points and potential routes, and to identify possibilities for improving the scheme;
- ❖ An improved waste collection scheme was developed that specified the number of containers and collection points, routes, and time and frequency of waste collection and transportation;
- ❖ A full cost-accounting methodology was utilized to calculate annual costs and plan investments;
- ❖ A meeting was held to discuss and evaluate the waste collection scheme, the cost recovery plan, and fee levels;
- ❖ A potential cost recovery structure (cost allocation and fee levels) was formulated to finance the pilot scheme in the first and upcoming years;
- ❖ Formal approval of fiscal package by the Communal Council

OBJECTIVE 2

To provide technical assistance in tender procedure for purchasing waste bins and garbage trucks

Performance indicator

- ❖ A ToR document was produced that provides technical specifications for garbage trucks and containers;
- ❖ The Commune organized a tendering procedure for purchasing trucks and containers;
- ❖ The Commune purchased one garbage truck and 155 containers



OBJECTIVE 3 To enable the commune to set up a waste management structure to provide support in preparing regulations and guideline tools	
Performance indicator	❖ Technical assistance was provided to working group on how to organize the service, how to define human needs for the brigade, clear roles and responsibilities, and how to set up the commune management structure related to waste management; ❖ The Communal Council approved the establishment of a cleaning brigade for the commune; ❖ Communal regulations on waste management were established that specify the role of the commune, brigade, companies, inhabitants, and landowners; the concrete tasks and responsibilities of each partner; and enforcement mechanisms and sanctions; ❖ An action plan for 2010-14 was produced as a guideline document for SWMP implementation. The action plan defined targets, activities, responsibilities, and required budget for each activity. It includes operational, institutional, financial, and monitoring measures and proposes a public awareness campaign to facilitate the implementation of the scheme; ❖ Monitoring and reporting forms were prepared
OBJECTIVE 4 To increase capacity-building for the team of Commune of Guri i Zi	
Performance indicator	❖ Four meetings were held with the working group in which commune staff members were provided with knowledge and practical assistance on waste management applications



raporti
vjetor

2009



Përgatiti në shqip
Rudina Toto, Darina Kokona

Përkthyer në anglisht
Darina Kokona

Korrektimi letrar në anglisht
Benjamin White

Korrektimi letrar në shqip
Olta Çakçiri

Dizenjimi
CreoSTD



Shtypur në
Afrojditi



Qeverisja e Mirë Vendore dhe Co-PLAN	7
Co-PLAN si Institut Kërkimor	9
Shërbimet dhe Ekspertiza në Co-PLAN	10
Ngjarjet kryesore të 2009	15
Sinergjia Akademike në Co-PLAN	35
Drejtuesit e Co-PLAN	36
Transparenca e Co-Plan	40
Projektet 2009	42










Të nderuar Miq dhe Kolegë,

Është kënaqësi që, në vijim të traditës, edhe këtë vit të përcjellim tek ju eksperiencën dhe rezultatet e punës së Co-PLAN. Përmes këtij dokumenti, jo vetëm ndajmë arritjet dhe sfidat tona me ju, por duam të komunikojmë sa më gjerë mënyrën dhe përpjekjet tona për të ndikuar në forcimin e institucioneve dhe standardeve, të shoqërisë civile shqiptare dhe veçanërisht të profesionistëve të rinj.

Me punën tonë përpiqemi të kontribuojmë veçanërisht në sfidën madhore të Shqipërisë, atë të integritetit Evropian. Kontributi ynë është i mbrujtur me vlerat në të cilat ne besojmë, vlerat që i ndajmë me bashkëpunëtorët dhe mbështetësit tanë dhe të cilat dëshirojmë t'i përçojmë edhe në brezin e ri të profesionistëve të qeverisjes urbane.







Qeverisja e Mirë Vendore dhe Co-PLAN

Gjatë dy dekadave të fundit, reforma e decentralizimit të pushtetit ka qenë dhe vazhdon të jetë një nga proceset kryesore në themel të formësimit të qeverisjes së mirë vendore dhe demokracisë lokale në Shqipëri. Krahasuar me vendet e tjera të Evropës Lindore, Shqipëria e ka nisur këtë reformë relativisht më vonë në kohë. Një vonesë e tillë e ka pajisur Shqipërinë me avantazhin e të mësuarit nga eksperiencat ndërkombëtare dhe me mundësinë për të reflektuar mbi hartimin dhe zbatimin e të gjitha reformave politike dhe sektoriale që kontribuojnë në qeverisjen e mirë. Në praktikë, progresi i decentralizimit vlerësohet pozitiv, por kurba paraqet edhe oshilacione, të cilat më tepër sesa cenim të autonomisë vendore tregojnë se decentralizimi është në fazat e hershme të konsolidimit të tij dhe kështu ka ende vend për të korrigjuar veprimet tona. Në kuadër të decentralizimit dhe forcimit

të qeverisjes së mirë vendore, një pjesë e mirë e kornizës ligjore është hartuar dhe mbart standarde të sistemit ligjor evropian. Megjithatë, nisur nga dinamika që karakterizon një sistem ligjor që duhet t'i përgjigjet një vendi në transicion intensiv zhvillimi dhe fakti se proceset zhvilluese në Shqipëri janë ende në statusin e “reformës”, ka ende punë për të bërë për sa i përket plotësimit të kornizës ligjore, standardeve dhe kapaciteteve ekzekutive. Padyshim, kjo do të vazhdojë të shoqërohet me nevojën për reformimin profesional dhe organizativ të institucioneve publike si edhe me hartimin dhe zbatimin e instrumenteve konkrete që sjellin ndryshimin për qytetarët, duke synuar veçanërisht krijimin e standardeve në çdo sektor. Sfida madhore e shqiptarëve është integrimi evropian dhe mbarëshoqëror. Në këtë këndvështrim, sfidat e qeverisjes janë:

- Konsolidimi i decentralizimit (ligjor, financiar) si një instrument për të arritur qëllimin – ofrimin e shërbimeve cilësore dhe me standarde pranë qytetarëve – duke zbatuar me korrektësi parimet e autonomisë, eficiencës dhe subsidiaritetit;
- Përafrimi me legjislacionin dhe institucionet evropiane me qëllim integrimin institucional;
- Krijimi i kornizës për zhvillim rajonal, në përputhje me kërkesat evropiane dhe njëkohësisht në përgjigje të nevojës për barazi të brendshme hapësinore;
- Forcimi i burimeve njerëzore në institucionet publike në drejtim të hartimit të instrumenteve cilësore për qeverisjen dhe të zbatimit korrekt të tyre;
- Krijimi i praktikave të mira të qeverisjes vendore si modele të suksesshme për replikim.



Co-Plan si Institut Kërkimor

Projektet dhe nismat e ndërmarra nga Co-PLAN së bashku me partnerët e tij përgjatë një bashkëpunimi të frytshëm, kanë qenë një demonstrim i praktikave të mira të menaxhimit urban, të cilat lindën nga eksperiencat bazë të zhvillimit dhe u rritën drejt një pune kërkimore të mirëfilltë. Këto procese kanë çuar drejt hartimit të dokumenteve të politikave dhe kontributeve domethënëse në bërjen e politikave si në nivelin rajonal ashtu edhe në atë kombëtar.

Që prej vitit 2007, Co-PLAN ka rritur në mënyrë të ndjeshme interesin e tij në ndikimin e politikëbërjes në Shqipëri. Në këtë drejtim, Co-PLAN ka ndërmarrë më tej punën kërkimore në fushën e politikave duke synuar ofrimin e rekomandimeve për politikat publike. Ky moment përfaqëson një evolucion kyç të kapaciteteve të organizatës, duke e ngritur angazhimin tonë afatgjatë për zhvillimin e instrumenteve të qeverisjes dhe mobilizimin e proceseve me pjesëmarrje në nivelin e ndikimit të politikave publike.

Co-PLAN ka identifikuar në mënyrë strategjike katër fusha kryesore për ndërhyrje me qëllim ndikimin në proceset e politikëbërjes, të cilat konsistojnë në: 1) monitorimin e zbatimit të politikave aktuale dhe propozimet për përmirësime të veçanta, 2) analizën e çështjeve zhvillimore relevante dhe me prioritet të lartë si edhe propozimet për hartimin e politikave të caktuara publike të cilat adresojnë këto çështje, 3) monitorimin dhe analizimin e zbatimit të legjislacionit ekzistues si edhe propozimet për përmirësime ose/dhe për hartimin e ligjeve të reja, 4) monitorimin vjetor të institucioneve publike apo të performancës së sektorit si edhe hartimin e deklaratës së performancës.

Të katër këto fusha mund të gjejnë zbatim në të gjitha fushat tematike ku Co-PLAN është aktiv nëpërmjet projekteve të zhvillimit dhe ekspertizës përkatëse, të cilat emërtohen si më poshtë vijon:

Zhvillimi Rajonal dhe Urban
Menaxhimi Mjedisor Urban
Strehimi

Financat Vendore

Qeverisja e mirë Urbane (ndërsektoriale)
Më konkretisht, përgjatë periudhës 2009-2010, Co-PLAN është angazhuar në katër disiplina të politikave, të emërtuara: Rajonalizimi i Shqipërisë, Menaxhimi i Integruar i Mbetjeve të Ngurta, Industria e Strehimit dhe Taksa e Pronësisë. Përgjatë eksplorimit të dy çështjeve të para, Co-PLAN ka mundur të jetë i suksesshëm duke u përfshirë në proceset e politikave përkatëse të iniciuara nga qeveria. Ndërkohë, dy disiplinat e fundit janë të ndërlidhura ngushtë me njëra-tjetrën dhe, nëpërmjet eksplorimit të tyre, Co-PLAN synon të influencojë procesin e administrimit të tokës në Shqipëri. Rekomandimet e politikave për këto disiplina të përmendura janë të vlefshme për institucionet publike, si në nivelin vendor ashtu dhe në atë qendror, sikurse edhe për sektorin privat.

Shërbimet dhe Ekspertiza në Co-PLAN

Gjatë vitit 2009, Co-PLAN është angazhuar intensivisht në mbështetjen e institucioneve publike, në nivel vendor dhe qendror, duke synuar të ndikojë procesin e politikëbërjes dhe praktikën e menaxhimit publik për një qeverisje të mirë vendore. Co-PLAN e realizon këtë mbështetje përmes

- ❖ bashkëpunimit profesional me institucionet dhe donatorët në hartimin e politikave publike që lidhen drejtpërdrejt me reformën e decentralizimit dhe qeverisjen e mirë;
- ❖ bashkëpunimit të ngushtë përmbajtjesor me njësitë e qeverisjes vendore në punën për hartimin e instrumenteve bashkëkohore dhe të reja për praktikën shqiptare të qeverisjes vendore;
- ❖ bashkëpunimit të ngushtë me institucione arsimore, në nivel mësimdhënieje dhe kërkimi shkencor, me qëllim reformimin konceptual mbi qeverisjen vendore në brezat e rinj të profesionistëve


si edhe zgjerimin e praktikës së Co-PLAN në laboratorin urban shqiptar.

Instrumentet apo ekspertiza dhe proceset e kërkimit shkencor dhe politik që Co-PLAN ka zhvilluar gjatë vitit 2009 dhe mbi bazën e ecurisë së të cilave bëhet planifikimi i zhvillimit strategjik të organizatës në të ardhmen, përfshijnë:

- ❖ thellimin e ekspertizës në hartimin e planeve territoriale për njësitë vendore;
- ❖ thellimin e ekspertizës në lidhje me financat vendore dhe publike në përgjithësi, përmes mbështetjes, në nivel vendor dhe qendror, për formësimin praktik dhe ligjor të instrumenteve si Plani i Investimeve Kapitale dhe Buxheti Afatmesëm për njësitë vendore;
- ❖ thellimin e ekspertizës në hartimin e instrumenteve praktike vendore për menaxhim mjedisor (EMAS) dhe menaxhimin e integruar të mbeturinave urbane;






- ❖ zgjerimin e ekspertizës në drejtim të hartimit dhe pilotimit të instrumenteve novatore të menaxhimit të tokës me qëllim mbështetjen ndaj njërive vendore në menaxhimin e territorit dhe balancimin e interesave private me ato publike;
- ❖ zgjerimin e temave të kërkimit shkencor me qëllim politikëbërjen si: reformimi i taksës së pronës, roli i qarkut në kornizën e integruar të decentralizimit dhe zhvillimit rajonal, strehimi në ekonominë e ndërtimit, menaxhimi i integruar dhe eficient i mbeturinave të ngurta urbane në kontekstin shqiptar, eficientia e energjisë në banesa etj.;
- ❖ angazhimin e drejtpërdrejtë në grupet teknike që po hartojnë politika të rëndësishme publike kombëtare dhe legjislacion në lidhje me zhvillimin rajonal dhe planifikimin urban.

Ekspertiza dhe Shërbimet e Co-PLAN janë strukturuar në pesë fusha tematike.











Ngjarjet kryesore të 2009



Tryeza Kombëtare mbi Menaxhimin e Mbetjeve Urbane **“Nevoja për të kaluar nga grumbullimi i mbetjeve në menaxhimin e integruar”**

Gjatë takimit të fundit të mbajtur me grupin e punës të sektorit të mjedisit (Komiteti i Koordinimit të Donatorëve) u diskutuan hapat e mëtejshëm që duhen ndjekur lidhur me procesin e hartimit të Planit Kombëtar për Menaxhimin e Mbetjeve.

Konkluzioni kryesor i këtij takimi ishte nevoja për të krijuar një komunikim efektiv në nivelin horizontal, midis institucioneve përgjegjëse për hartimin e politikave në nivel qendror, si edhe në nivelin vertikal, duke u fokusuar tek forcimi i komunikimit ndërmjet institucioneve në nivel

qendror dhe pushtetit vendor. Në këtë kuadër, Tryeza Kombëtare për Menaxhimin e Integruar të Mbetjeve Urbane pati si qëllim të adresojë këtë çështje kyçe nëpërmjet ndërtimit të një dialogu mes qeverisjes vendore dhe asaj qendrore (institucioneve përkatëse të cilat janë përgjegjëse për menaxhimin e mbetjeve të ngurta). Më tej, kjo tryezë kishte objektivin madhor të prezantonte Planin Kombëtar për Menaxhimin e Mbetjeve tek përfaqësuesit dhe ekspertët e qeverisjes vendore me qëllim identifikimin e rolit dhe përgjegjësi të njësive të qeverisjes

vendore në zbatimin e tij të mëtejshëm në praktikë.

Organizimi i kësaj tryeze si nismë e Co-PLAN u mundësua në bashkëpunim me Ministrinë e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave, Ministrinë e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit, Shoqatën e Bashkive të Shqipërisë, kompaninë “Grontmij Carl Bro” si edhe Programin Për Qeverisjen Vendore në Shqipëri (USAID). Tryeza kombëtare u zhvillua në ambientet e Hotel Sheraton në Tiranë, më datë 15 Dhjetor 2009.



Co-PLAN në Forumin Mjedisor të BE-së

Në frymën e një qasjeje mjedisore në kontekstin e Bashkimit Evropian (BE), Co-PLAN iu bashkua Forumit të Mjedisit, një projekt i financuar nga Komisioni Evropian që u drejtohet grupeve të synuara të organizatave mjedisore jofitimprurëse (të vendeve si Kroacia, Ish-Republika Jugosllave e Maqedonisë, Shqipëria, Bosnja dhe Hercegovina, Mali i Zi, Serbia,

Kosova nën UNSCR dhe Turqia) të cilat shfaqin interes dhe janë të përfshira në procesin e zgjerimit të BE-së. Forumi synon të mbështesë OJF-të në rolin aktiv dhe konstruktiv që ato mund të luajnë lidhur me proceset e zgjerimit.

Ky projekt bazohet në nisma të mëparshme si Dialogu i OJF-ve dhe Forumi i OJF-ve të Reja, të cilat

kishin në fokus shkëmbimin dhe përmirësimin e informacionit lidhur me transparencën midis OJF-ve dhe Komisionit. Një nga qëllimet e rëndësishme të këtij forumi është zhvillimi i kapaciteteve të OJF-ve mjedisore për ndërtimin e një dialogu konstruktiv me autoritetet kombëtare.






Dita e Hapur e Holandës

Gjatë aktivitetit të organizuar në nder të Ditës së Hapur të Holandës, në 9 Dhjetor 2009, një botim i ri, shoqëruar me një ekspozitë dhe një dokumentar, u prezantua në ambientet e Universitetit Polis, i cili e mirëpriti këtë aktivitet të rëndësishëm në kuadër edhe të përvjetorit të 14-të të institutit kërkimor Co-PLAN pranë këtij institucioni. Libri “Midis Vakumit dhe Energjisë - Eksperienca të Co-PLAN mbi Zhvillimin Urban në Shqipëri”, i tre autorëve Besnik Aliaj, Sotir Dhamo

dhe Dritan Shutina, u prezantua dhe u shpërnda ndër partnerët, bashkëpunëtorët, studentët si dhe ndër publikun e gjerë pjesëmarrës. Si pjesë e programit, një dokumentar i titulluar “Holanda nga Lart”, me autor Wim Robberechts & Co, u shfaq dhe u pasua më tej nga një ekspozitë fotografie me temë “Holanda përmes Bicikletës” dhe një koktej përmbyllës.

Në ceremoninë festive ishin të pranishëm rreth 200 pjesëmarrës. Ceremonia u drejtua nga drejtori i Co-

PLAN, Z. Dritan Shutina, Ambasadori i Mbretërisë së Vendeve të Ulëta në Tiranë, Z. Henk G.C Van der Dool, Rektori i U_POLIS, Z. Besnik Aliaj si edhe Z. Sef Slootweg në cilësinë e bashkëthemeluesit të Co-PLAN, i cili lexoi gjithashtu edhe letrën e dërguar nga “Cordaid”, Netherlands – organizatë partnere Holandeze që prej themelimit të Co-PLAN. Z. Sotir Dhamo, një nga themeluesit e U_POLIS dhe anëtar i bordit të Co-PLAN, paraqiti për të ftuarit një sintezë të botimit të ri.



EKSPLO POLIS

Në kuadër të punës dhe bashkëpunimit të ndërsjellë me Institutin Kërkimor Shkencor të Universitetit Polis, Co-PLAN mori pjesë në bashkorganizimin dhe

realizimin e Ekspo Polis, një aktivitet i përvitshëm i cili përmbledh punimet më të mira të studentëve të këtij universiteti në një shfaqje dinjitoze të punës për publikun e

gjerë. Botimet e Co-PLAN erdhën si pjesë e pasurimit të kësaj ekspozite së bashku me asistencën teknike për institucionet publike dhe materialet për studentët.



Co-PLAN

“City Made by People”
1996 - 2008


photo gallery, publications

City Made by People represents, from the experience of Co-PLAN, the first phase of urban developments in Albania after the changes in 1990. This phase (1990-2000) is a

project”

ctural drawings
models, photos
video 30’

s first built
for 93 families.
more than 1.000



The micro scale of the neighborhood is the urban laborator
our time, where new economies and socio-cultural relations
produced. Here, official suburban parcels have been retrofi
with alternative uses and informal economies that
setbacks and blur private and public


Co-PLAN në Bienalen e Artit Bashkëkohor Ndërkombëtar, Tiranë 2009 **“Eficiencia Simbolike e Kornizës”**

Këtë vit, Bienalja ekzaminoi mungesat që rezultojnë si pasojë e zhvillimeve të qyteteve bashkëkohore të orientuara më shumë nga fitimi dhe individi, duke theksuar mundësitë që kanë qytetarët për të kontribuar në atë që mund të jetë e ardhmja e qyteteve të tyre. Në një përpjekje për t’iu përgjigjur në mënyrë kritike zhvillimeve aktuale të Tiranës, të vendosura brenda një konteksti neoliberal, T.I.C.A.B u shtri përtej fushës së arteve pamore, drejt sferës së arkitekturës dhe proceseve të urbanizimit, duke përfshirë arkitektë, artistë, kuratorë kulturorë, aktivistë

dhe gazetarë nga rajoni i Ballkanit Perëndimor dhe nga një kontekst më i gjerë global.

Co-PLAN dha kontributin e tij në këtë aktivitet nëpërmjet ofrimit të praktikave të mira urbane dhe metodologjive të zhvilluara përgjatë punës së vet në vite. Punët dhe dokumentimet e Co-PLAN (Instituti për Zhvillimin e Habitatit) u përfshinë dhe u paraqitën së bashku me ato të Lorenz Aggermann; Eduard Freudmann; Can Gülcü; Sabine Bitter and Helmut Weber; Luise Donschen and Archis Interventions, Prishtina; Fifth Park; First Archi Brigade; Insider B92;

Vladan Jeremic and Rena Rädle; Civil Initiative Muzil; Right to the City, Zagreb. Në vijim, gjatë ditëve 3-6 Tetor 2009, në ambientet e Hotel “Dajtit” në Tiranë u zhvilluan, si pjesë e aktivitetit të Bienales, “Dialogët e Tiranës”, veprimtari kjo e bashkorganizuar me Z. Emiliano Gandolfi. Dialogët u mbajtën brenda hapësirës së Regjistrimit të qyteteve, projektuar me Z. Ajdin Basic, ku përfshiheshin qytetet Tiranë, Beograd, Kotorr, Novi Sad, Podgoricë, Prishtinë, Pul, Shkup dhe Zagreb. Co-PLAN bëri një prezantim kyç të eksperiencës së tij lidhur me zhvillimet urbane në Shqipëri.



Konferenca e Praktikave më të mira të Qeverisjes Vendore

Muaji Shtator 2009 shënoi realizimin e Konferencës mbi Praktikën më të mirë të Qeverisjes Vendore, një aktivitet i organizuar nga Programi për Qeverisjen Vendore në Shqipëri (LGPA), USAID, Shoqata e Bashkive në Shqipëri (ShBSh) dhe Universiteti Polis. Konferenca e Praktikave më të mira të Qeverisjes Vendore u dizajnuar për të lehtësuar shpërndarjen e praktikave më të mira të zbatuara në bashkitë e Shqipërisë tek njësitë e tjera të qeverisjes vendore (NjQV) në vend. Njësitë e Qeverisjes Vendore në Shqipëri janë duke vënë në përdorim ide novatore për të nxitur qeverisjen e mirë urbane, për të përmirësuar

ofrimin e shërbimeve si dhe për t'iu përgjigjur më mirë qytetarëve. Duke qenë se përvoja ka treguar se shkëmbimi i eksperiencave mes homologësh është një nga metodat më të mira për të çuar përpara idetë dhe aftësitë e reja, kjo konferencë u mundësoi bashkive të ekspozonin punën e tyre për njësitë e tjera të qeverisjes vendore si dhe për palët e interesuara por, në të njëjtën kohë, edhe të mësonin nga eksperiencia e bashkive dhe organizatave të tjera profesionale.

Kontributi i Co-PLAN në këtë konferencë u realizua nëpërmjet pjesëmarrjes aktive në tre shtyllat

kryesoretëve primtarisë dhe konsistoi në: prezantimin e eksperiencës së Co-PLAN në qeverisjen e mirë gjatë Panairit të Pushtetit Vendor, prezantimin e rasteve studimore të Co-PLAN në librin “Praktikat më të mira Bashkiake” dhe mbajtjen e tre prezantimeve të hapura mbi planifikimin urban dhe financat bashkiake, të cilat u paraqitën nga ekspertë të Co-PLAN për një publik të gjerë me përfaqësues të NjQV-ve, institucioneve publike e profesionale dhe donatorëve. Konferenca e Praktikave më të mira të Qeverisjes Vendore u zhvillua në datat 17 dhe 18 Shtator 2009 në Tiranë.




Vizitë Studimore mbi Menaxhimin e Mbetjeve të Ngurta

Në kuadër të projektit për “Fuqizimin e Performancës Mjedisore në nivel vendor nëpërmjet pilotimit të eksperiencës për Menaxhimin e Mbetjeve të Ngurta në Fier”, i cili është duke u zbatuar në bashkëpunim me Bashkinë Fier, Co-Plan si edhe Këshilltarë mbi çështjet e zhvillimit

urban dhe atij mjedisor organizuan një vizitë studimore pesëditore gjatë periudhës 31 Gusht - 4 Shtator 2009 në Gouda, Holandë. Kjo vizitë studimore u financua nga Ambasada e Vendeve të Ulëta në Tiranë dhe në të morën pjesë përfaqësues të administratës së pushtetit vendor Fier si edhe

ekspertë të Co-Plan, të cilët ishin pjesë e delegacionit shqiptar në këtë veprimtari.

Pjesëmarrësit morën leksione të ndryshme nga BE dhe Vendet e Ulëta lidhur me çfarë mund të gjejë përshtatje në zbatim gjatë procesit të menaxhimit të mbetjeve në kontekstin shqiptar.



Co-Plan në Rrjetin e Evropës Juglindore-Archis

Co-Plan është një nga organizatat partnere në Rrjetin e Evropës Juglindore Archis, një rrjet ky i nismave të pavarura urbane në Evropën Juglindore i cili u krijua nga Kai Vockler në emër të Archis, në bashkëpunim me Srdjan Jovanović Weiss, me qëllimin për të nxitur njohuritë dhe shkëmbimin lidhur me çështjet urbane, për të integruar

dialogun mbi urbanizmin si edhe për të mbështetur nismat në nivel vendor. Organizata nga Sllovenia, Kroacia, Bosnja dhe Hercegovina, Serbia, Mali i Zi dhe Shqipëria janë gjithashtu pjesë e këtij rrjeti. Në këtë kuadër, Co-Plan ka marrë pjesë dhe ka dhënë kontributin e tij në aktivitete të ndryshme, seminare dhe takime të organizuara në rajon mbi çështje

të arkitekturës dhe urbanizmit së bashku me nismat e tjera partnere nga vendet e Evropës Juglindore si: Platforma 9.81, (Instituti për Kërkime në Arkitekturë) në Split, Kroaci; Archis Interventions, Rotterdam, Holandë, Analog në Zagreb, Kroaci; Expeditio në Kotor, Mali i Zi dhe Pulska Grupa në Pula, Kroaci.



Lidershipi Shqiptar 2009

Për të gjashtin vit rresht, Co-PLAN organizoi Ceremoninë e dhënies së Çmimit të “Lidershipit Shqiptar” e cila u organizua në ambientet e Hotel “Sheratonit”. Eksperienca e deritanishme ka treguar që Çmimi i “Lidershipit Shqiptar” tashmë është konsoliduar. Ky çmim synon të kthehet në një institucion të shoqërisë Shqiptare.

Në ndryshim nga vitet e mëparshme, ku publiku supozohej të propozonte kandidaturat për fushat përkatëse dhe Komiteti i Lidershipit gëzonte

të drejtën e përzgjedhjes nga këto kandidatura, këtë vit, pas një reflektimi me partnerët e kësaj iniciative, u mendua një formë tjetër organizimi e mënyrës së propozimit dhe përzgjedhjes së kandidaturave të mundshme për kategoritë e sipërpërmendura, duke iu referuar edhe përvojave të tjera serioze ndërkombëtare.

Në strukturën aktuale u mundësua ngritja e pesë Ekipeve Propozuese dhe pesë Ekipeve Përzgjedhëse për kategoritë përkatëse, në përbërjen e të cilave ishin disa nga figurat

më me impakt në shoqëri dhe më të spikatura për kompetencën profesionale dhe kontributin për problemet sociale, përfshi anëtarë të Asamblesë së “Miqve të Lidershipit”.

Ndër personalitetet që kontribuan në përzgjedhjen e çmimeve të sivjetshme janë: Znj. Valdet Sala, Z. Bashkim Hoxha, Z. Ermir Dobjani, Znj. Vasilika Hysi, Z. Ilir Zhilla, Znj. Eglantina Gjermani, Z. Aldo Bumçi, Z. Adi Krasta, Z. Altin Hazizi, Znj. Arlinda Çausholli, Z. Bashkim Sala, Z. Skënder Minxhozi, Z. Besnik Aliaj, Z. Sotir Dhamo, Z. Dritan Shutina.



SHOQËRIA CIVILE

Fondacioni Shqiptar për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara

Fondacioni Shqiptar për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara, falë punës, arritjeve dhe përkushtimit të tij, ka zënë një vend të respektueshëm në ‘odeonin’ e publikut të gjerë dhe sidomos ndër komunitetet të cilave ai u shërben. Gjatë këtyre 13 viteve aktivitet, Fondacioni ka arritur të përfaqësojë personat me aftësi të kufizuar dhe të advokojë suksesshëm në emër të tyre duke sjellë, së bashku me ta, një ndryshim të prekshëm në mentalitetin e shoqërisë shqiptare.

MEDIA

Z. Rezart Xhaxhiu

Rezart Xhaxhiu është një nga gazetarët profesionistë më të spikatur të medias së shkruar dhe elektronike, me një karrierë solide që ka evoluar me dinjitet ndër kohë. Ai vlerësohet si një nga reporterët më të besueshëm të Radio Tiranës, sidomos për raportimet e tij pranë Këshillit të Evropës. Duke vlerësuar karrierën e Z. Rezart Xhaxhiu, “Lidershipi Shqiptar” njeh kontributin e çmuar të gjithë atyre mediave dhe profesionistëve me integritet që kanë punuar dhe sakrifikuar gjatë transicionit kompleks të Shqipërisë.

SEKTORI PRIVAT - BIZNESI

Dajti Ekspres

Dajti Ekspres është një investim serioz turistik dhe një shërbim cilësor për shoqërinë në tërësi që kontribuon jo vetëm për komunitetin e qytetit të Tiranës por edhe më gjerë në rajon, duke shërbyer si një shembull mjaft i mirë i mënyrës me të cilën potencialet e fjetura natyrore e turistike të vendit mund të rizgjojnë përmes investimeve të tilla strategjike. Është për t’u theksuar se “Teleferiku i Tiranës” - siç e quajnë qytetarët e thjeshtë - demonstroi një teknologji, shërbim dhe siguri bashkëkohore të standardit të BE-së, i cili impakton



Çmimet e Lidershipit Shqiptar 2009

padyshim imazhin jo vetëm të Tiranës por edhe të Shqipërisë turistike në tërësi. Përmes këtij çmimi, “Lidershipi Shqiptar” vlerëson dhe inkurajon iniciativën dhe kreativitetin e sipërmarrjes së mirëfilltë shqiptare, e cila garanton integrimin real të Shqipërisë me botën moderne.

QEVERISJA

Njësia e Transportit Mjekësor me Helikopter

Njësia e Transportit Mjekësor me Helikopter është një nga strukturat më të qëndrueshme dhe serioze të shtetit shqiptar e cila ka dëshmuar profesionalizëm dhe shpirt sakrifice

në situata komplekse të emergjencës, krizave apo fatkeqësive me karakter social dhe natyror. Duke vlerësuar “Njësinë e Helikopterëve” pranë Ministrisë së Shëndetit Publik, “Lidershipi Shqiptar” përulet me respekt të thellë përballë shpirtit të sakrificës së pilotëve dhe stafit të gjithë ekipeve të emergjencave, të cilët kanë humbur jetën në misione të vështira shpëtimi.

ÇMIMI SPECIAL I LIDERSHIPIT SHQIPTAR 2009 Arbën Xhaferri

Arbën Xhaferri është një nga politikanët më seriozë shqiptarë

në kohët moderne dhe mbetet padyshim një nga intelektualët më të çmuar e me ndikim në Maqedoni, Kosovë dhe Shqipëri. Z. Xhaferri njihet si avokat i të drejtave të shqiptarëve në Maqedoni dhe ka publikuar disa botime serioze mbi këtë çështje. Ai njihet si iniciuesi i ndryshimit të preambulës së Kushtetutës Maqedonase dhe si ndërtuesi i platformës për demokraci konsensuale. Me këtë vendim, “Lidershipi Shqiptar” nderon edhe shqiptarët e Maqedonisë, të cilët në mënyrë të heshtur dhe në vazhdimësi japin kontributin e tyre të çmuar në artikullimin e çështjes kombëtare.



Sinergjia Akademike në Co-PLAN

Kontributet dhe prurjet në kërkimin mbi zhvillimin urban vazhdojnë të mbeten një faktor kyç suksesi për Co-PLAN si pjesë e Institutit Kërkimor të U_POLIS.

Artikujt e publikuar nga Co-PLAN në Revistën Shkencore të U_POLIS (Forum A+P) kanë shtuar vlera nëpërmjet kontributeve kërkimore si edhe praktikave dhe eksperiencave më të mira të fituara, të cilat e kanë çuar përpara praktikën e terrenit drejt prurjes akademike.

Viti 2009, krahas viteve të tjerë, solli në vëmendje çështje të rëndësishme që lidhen me ndërtimin e qyteteve krijues, rajonalizimin dhe menaxhimin rajonal e urban, të cilat janë prekur dhe paraqitur në artikujt e poshtëshënuar.

Ekspertë të lartë të Co-PLAN pasurojnë në mënyrë konstante kurrikulat akademike ndërkohë që, nëpërmjet dhënies së leksioneve, informacioni mbi praktikën më të mira shpërndahet në mjedisin akademik duke mundësuar një mentalitet të ri të qasjes ndaj planifikimit dhe qeverisjes së mirë urbane në Shqipëri.

- Planifikimi Urban: Alibi apo domosdoshmëri - nga Dritan Shutina
- Rajonalizimi i Shqipërisë përkundrejt Reformës Territoriale - nga Rudina Toto
- Administrimi i Hapësirës Publike në Shqipëri – një qasje kritike në lidhje me rolin e qeverisjes qendrore dhe lokale për planifikimin dhe administrimin e territorit - nga Enton Derraj
- Koncepti i Qytetit Krijues në Kontekstin e Rajonit Ballkanik - nga Peter Nientied & Rudina Toto
- Nga Komunizmi në Përtëritjen Urbane dhe Ndryshimin Social – rasti studimor i Tiranës - nga Dorina Nikolla

Bordi Drejtues



Sokol Çelo - Drejtor i Bordit Drejtues

Sokol Çelo po kryen studimet e doktoraturës për Biznes Ndërkombëtar në “Florida International University” duke u specializuar në këndvështrimin institucional të investimeve të huaja në vendet ish-komuniste dhe ato në transicion. Më parë është diplomuar si matematikan në Universitetin e Tiranës dhe më tej ka përfunduar programin Master në Administrim Biznesi të ofruar nga Universiteti i Tiranës dhe ai i Nebraskës. Ai e filloi karrierën e tij profesionale në fushën akademike si pedagog i matematikës në Universitetin e Tiranës dhe vazhdoi më tej në fushën e projekteve zhvillimore duke punuar si menaxher projekti për GTZ dhe më vonë për PNUD. Është anëtar dhe Kryetar i Bordit Drejtues të Co-Plan që prej vitit 2002.



Besnik Aliaj - Anëtar

Diplomuar në Arkitekturë-Urbanistikë nga Universiteti i Tiranës. Më pas ka marrë titullin Master në Zhvillim dhe Menaxhim Urban nga IHS-Rotterdam dhe Universiteti Erasmus, Holandë. Në vitin 2007 mbron titullin “Doktor i Shkencave” në Universitetin Politeknik të Tiranës. Pas dy viteve eksperiencë pune në qeverisjen vendore, zotëron 17 vjet eksperiencë akademike pranë Universitetit Politeknik, Akademisë së Arteve të Bukura, Universitetit “Polis” në Tiranë dhe Universitetit Teknik të Darmstadt, Gjermani. Eksperiencë 10-vjeçare me shoqërinë civile. Bashkëthemelues dhe ish-drejtuës i Co-PLAN; ish-Sekretar i Përgjithshëm i Shoqatës së Arkitektëve të Shqipërisë; bashkëthemelues i Platforma-IDR, Instituti për Demokraci e Reforma. Këshilltar i Kryeministrit për planifikimin dhe menaxhimin e territorit në periudhën 2005/7. Bashkëthemelues dhe Rector i Universitetit “Polis” dhe autor i disa


botimeve profesionale. Ka fituar çmimin “Fisnikëria Tiranase” në vitin 2004 dhe çmimin “Qytetar Nderi i Kamzës” në vitin 2006.




Sotir Dhano - Anëtar

Diplomuar si Planifikues Urban nga Universiteti i Tiranës; më pas fiton titullin Master në Administrim Publik nga Universiteti i Sirakuzës, ShBA. Ka ndjekur programe të ndryshme pasuniversitare në disa vende të Evropës. Eksperiencë e gjatë në mësimdhënie, si në universitetin publik ashtu edhe në atë privat. Një nga bashkëthemeluesit e Universitetit POLIS, ku aktualisht kryen funksionin e Administratorit të Përgjithshëm, pa lënë pas dore edhe mësimdhënien. Autor i disa artikujve të botuar në gazeta dhe revista lokale apo të prezantuar në aktivitete ndërkombëtare. Eksperiencë e gjatë pune në administratën publike si edhe në shoqërinë civile, me fokus në hartim dhe zbatim projektsh, hartime planesh rregulluese si edhe në zhvillim institucional dhe forcim organizativ. Ka punuar pranë Co-PLAN për rreth 5 vjet, ku edhe ka qenë anëtar i Bordit Ekzekutiv të organizatës.


Bordi Këshillimor



Ferry van Wilgenburg ka një eksperiencë të gjatë ndërkombëtare në fushën e menaxhimit urban dhe strehimit, në veçanti në vendet Aziatike dhe ato të Evropës perëndimore dhe lindore. Aktivitetet e tij ndërkombëtare janë fokusuar në ngritje dhe forcim kapacitetesh, trajnime dhe shërbime konsulence. Gjatë nëntë viteve të fundit ai ka punuar kryesisht në Holandë. Në Bashkinë e qytetit të Roterdamit ai ka punuar si menaxher i programit për zhvillimin e lagjes si edhe drejtues i departamentit të prokurimeve të pasurive të paluajtshme. Prej katër vitesh punon në një korporatë të banesave sociale, në pozicionin e menaxherit të pasurive të paluajtshme. Ai është përgjegjës për mirëmbajtjen e 14,000 banesave si edhe për zhvillimin dhe zbatimin e programeve të qëndrueshmërisë për organizatën.




Valdet Sala ka qenë anëtare e Bordit Drejtues të Co-PLAN nga viti 2002 deri në vitin 2007 dhe konsulente e jashtme e organizatës që nga viti 1999. Aktualisht, ajo është menaxhere e një programi të GTZ/GOPA në përfshirjen e shoqërisë civile. Në karrierën e saj profesionale, Znj. Sala ka mbajtur poste të rëndësishme si Drejtoreshë e Bibliotekës Kombëtare, Drejtoreshë Programi tek Soros dhe konsulente mbi shoqërinë civile dhe çështjet gjinore. Ajo është themeluese e tri organizatave të cilat veprojnë kryesisht në çështjet gjinore dhe ka botuar një numër artikujsh mbi këto çështje si edhe ka përfaqësuar lëvizjen e femrave shqiptare në aktivitete kombëtare dhe ndërkombëtare. Në vitin 2005 asaj iu dha çmimi Lideri i Shqiptar për kontributin e vyer në sferën e shoqërisë civile.



Sef Slootweg është një nga bashkëthemeluesit e Co-PLAN. Ai ka punuar për shumë vite për zyrën Holandeze për kërkim dhe këshillim të politikave, kryesisht në çështjet urbane dhe sfidat e banesave sociale. Në vitin 1990 ai themeloi fondacionin Crossover me synim shkëmbimin e eksperiencave në fushën e strehimit ndërmjet ekspertëve Holandezë dhe atyre Shqiptarë. Kjo ishte shtysa për të ardhur në Shqipëri, ku Z. Slootweg u angazhua me studimet mbi rritjen e shpejtë dhe informale të zonave rezidenciale në Tiranë. Në vitin 1999 ai u bashkua organizatës SNV.



Peter Nientied është konsulent në fushën e zhvillimit organizativ dhe menaxhimit si edhe partner pranë De Boer & Ritsema van Eck (Holandë). Ka fituar gradën Master (me titull nderi) në Gjeografi Njerëzore dhe Planifikim dhe ka mbaruar studimet e doktoraturës në Shkenca Sociale nga Free University në Amsterdam si edhe një Master në Menaxhim Publik në Universitetin Twente në Holandë. Ai ka punuar për disa vite për IHS (Universiteti i Erasmusit, Rotterdam) në vende të ndryshme të Azisë, Amerikës Latine dhe Evropës. Në vitin 1999 ai iu bashkua kompanisë De Boer & Ritsema van Eck, i specializuar në zhvillim organizativ, zhvillim lidhshpi dhe menaxhim projekti, si dhe ofron konsulencë, trajnime dhe leksione në nivel Masteri mbi menaxhimin dhe lidhshpin. Peter Nientied ka qenë një bashkëpunëtor i Co-PLAN që në fillimet e tij. Prej 2008 ai është bashkëdrejtuesi me kohë të pjesshme i Kërkimit dhe Programit të Doktoraturave në Universitetin Polis.



John Driscoll është Drejtori i Qendrës Ndërkombëtare për Zhvillim Lokal dhe Rajonal (ICLRD), një qendër e kërkimit të aplikuar me vendndodhje në Armagh, Irlandë, e cila bashkon akademistë, praktikienë dhe politikëbërës të përfshirë në planifikim hapësior dhe zhvillim lokal e rajonal. Z. Driscoll është gjithashtu Zv/President i Institutit për Zhvillimin Urban Ndërkombëtar në Kembrixh, Masaçusets, dhe një kërkues shkencor në Qendrën për Studime të Strehimit të Universitetit të Harvardit. Ai ka punuar me kolegë nga Shqipëria në vitet 1994-1998 me qëllim për të zhvilluar qasje me bazë komunitare për rindërtimin dhe integrimin e zonave informale si edhe për të çelur programin për menaxhimin e tokës të financuar nga Banka Botërore.

Financat dhe Transparenca në Co-PLAN

Raport i auditorëve të pavarur
Për Drejtorin Ekzekutiv të Co-PLAN,
Instituti për Zhvillimin e Habitatit

Tiranë, më 21 Maj 2010

Ne kemi audituar bilancin kontabël të Co-PLAN, Instituti për Zhvillimin e Habitatit (e quajtur këtej e tutje si “Organizata” ose “Co-PLAN”) për periudhën 1 Janar 2009 deri më 31 Dhjetor 2009. Strukturat menaxhuese të Co-Plan janë përgjegjëse për përgatitjen dhe prezantimin e saktë të pasqyrave financiare. Përgjegjësia jonë është të japim mendim mbi këto pasqyra financiare bazuar në auditimin tonë.

Ne kemi kryer auditimin tonë në përputhje me Standartet Ndërkombëtare të Auditimit. Sipas këtyre standarteve ne jemi të detyruar të planifikojmë dhe ushtrojmë auditimin për të arritur një siguri të arsyeshme mbi faktin nëse këto pasqyra financiare nuk përmbajnë gabime ose shmangie materiale. Një auditim përfshin zbatimin e disa procedurave me qëllim marrjen e evidencës mbi shumat dhe paraqitjet në pasqyrat financiare.. Një auditim përfshin gjithashtu edhe vlerësimin e parimeve kontabël të përdorura dhe gjykimeve të rëndësishme të bëra nga strukturat menaxhuese, si edhe vlerësimin e paraqitjes së përgjithshme të pasqyrave financiare. Ne besojmë që evidenca e auditimit e siguruar prej nesh siguron një bazë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të dhënë gjykimin tonë.

Këto pasqyra financiare janë përgatitur bazuar në një kosto historike, sipas parimit të regjistrimit të dyfishtë, në përputhje me metodën “kontabilizim fondesh”, e cila ndryshon nga Standartet Kombëtare të Raportimit Financiar dhe Legjislacioni Shqiptar për Kontabilitetin.

Sipas vlerësimit tonë, pasqyrat financiare japin një pamje të vërtetë dhe të saktë të gjendjes financiare të Organizatës deri më 31 Dhjetor 2009, si dhe të performancës së vet financiare dhe të fluksit të parave për vitin që mbyllet, në përputhje me metodën “kontabilizim fondesh”.

Ky raport lëshohet për informacion dhe përdorim vetëm të strukturave menaxhuese të Organizatës dhe për donatorët e saj. Rrjedhimisht, materiali nuk duhet përdorur për qëllime të tjera dhe për këtë arsye nuk duhet shpërndarë pa marrë më parë pëlqimin tonë me shkrim.

KPMG Albania sh.p.k

Rr. Dëshmorët e 4 Shkurtit, Kullat Binjake, Ndërtesa 1, Kati 13

Tiranë, Shqipëri

Projektet 2009

1. *Ndikimi i Politikëbërjes*
2. *Asistencë teknike për njësitë e qeverisjes vendore Fushë-Arrëz, Vau i Dejës & Guri i Zi në kthimin e PSZh në instrumente dhe procese planifikimi dhe buxhetimi bashkiak nëpërmjet përmirësimit të praktikave të menaxhimit financiar*
3. *Zbatimi i Planit të Përgjithshëm Rregullues nëpërmjet nxitjes së zhvillimit të zonës së Parkut të Automjeteve si një gjenerues zhvillimi për qytetin*
4. *Studim Fizibiliteti për Ngritjen e një zone industriale në Lezhë*
5. *Fuqizimi i Performancës Mjedisore në Nivel Vendor nëpërmjet Menaxhimit të Mbetjeve Bashkiake në Fier si model pilot*
6. *Taksa e Pasurisë - një instrument për financimin novator në nivel vendor në Shqipëri*
7. *Delta - Vazhdimësia e mbështetjes në bashkitë e përzgjedhura (Berat, Durrës, Lezhë, Korçë dhe Shkodër) - Plan i Investimeve Kapitale*
8. *Planifikimi i Investimeve Kapitale në Bashkitë e Kukësit & Fushë-Krujës*
9. *Hartimi i Planit të Përgjithshëm Rregullues të Kukësit*

- 10. Hartimi i Planit të Përgjithshëm Rregullues të Bashkisë Fushë-Krujë*
- 11. Zbatimi i Planit Kombëtar për përafrimin e Legjislacionit të Mjedisit në Shqipëri - Studimi për Ndarjen e Mbeturinave në Shqipëri*
- 12. Reduktimi i energjisë së përdorur dhe i emetimeve të CO2 nëpërmjet partneritetit midis shoqërisë civile dhe pushtetit vendor për edukimin e popullsisë si dhe rritjes së efijencës termike në ndërtesat e banimit*
- 13. LOGIN - Rrjeti i informacionit mbi qeverisjen vendore (viti I)*
- 14. LOGIN - Rrjeti i informacionit mbi qeverisjen vendore (viti II)*
- 15. Vlerësimi bazë dhe kryerja e analizës për Kompetencat e Administratës Publike dhe Qeverisjes Vendore si dhe për Mjedisin e Zhvillimit të Kapaciteteve Vendore*
- 16. Hartimi i Planit të Menaxhimit të Mbetjeve Urbane në komunën Guri i Zi*
- 17. Vlerësimi i ecursisë së zbatimit të Planit për Menaxhimin e Mbetjeve Urbane në bashkinë e Fushë-Arrëzit*
- 18. Plani i Menaxhimit të Mbetjeve Urbane në Komunën e Dajçit*
- 19. Asistencë teknike në vazhdim për zbatimin e Planit të Administrimit të Mbetjeve Urbane në Komunën e Gurit të Zi*

I Ndikimi i Politikëbërjes

Koha e Zbatimit: 20 Dhjetor 2007 - 20 Dhjetor 2010

Donatori: Instituti për Shoqërinë e Hapur, OSI, Budapest

Fondi: Për 2007-2008 / \$65,000 – HRGGP OSI / \$ x – Co-PLAN

Zbatohet në: Tiranë




Në vitin 2007, Co-PLAN mobilizoi një Program 3-vjeçar për Punë Kërkimore të Aplikuar për Politika Publike qendrore dhe lokale me qëllim hartimin e politikave publike me një fuqi vepruese dhe zbatuese më të mirë si dhe ndikimin dhe ngritjen e këtyre politikave në një nivel më shkencor. Qëllimi i Co-PLAN është i dyfishtë dhe konsiston në: forcimin e mëtejshëm të kapaciteteve të brendshme në fushën e projekteve kërkimore dhe aplikimin e rezultateve të studimit të politikave me qëllim ndikimin e zhvillimit dhe zbatimit të tyre. Ky qëllim formësohet në një kontekst ku alternativat për politika të mirëfillta

dhe të zbatueshme ose mungojnë ose ngrihen mbi debate dhe vendimmarrje ad-hoc. Gjatë periudhës 2008-2009, programi “Ndikimi i Politikëbërjes” synoi të influencojë arenën e politikëbërjes në Shqipëri përmes zhvillimit të punës studimore për katër tema specifike:

- a. *Zhvillimi Rajonal dhe Lidhja e Ndërsjellë me Organizimin Territorial dhe të Qeverisjes*
- b. *Menaxhimi i Mbeturinave të Ngurta Urbane*
- c. *Strehimi – Industria e Ndërtimit*
- d. *Taksat lokale – Taksa e Pronësisë*

Të katër temat janë prioritare dhe kanë një ndjeshmëri të lartë politike. Ato janë diskutuar

në nivele të ndryshme publike dhe lidhen me çështje të zhvillimit ekonomik, decentralizimit, fuqizimit të qeverisjes vendore dhe forcimit të marrëdhënieve midis niveleve të ndryshme të qeverisjes. Gjatë periudhës 2008-2009, ekipi i Co-PLAN është trajnuar për të hulumtuar me profesionalizëm të katër temat, ka përgatitur dokumente me rekomandime politike për qeverinë dhe grupet e interesit dhe ka diskutuar publikisht gjetjet e punës kërkimore. Gjithashtu, është zgjuar interesi i grupeve të ndryshme për t'u përfshirë në zbërthimin e mëtejshëm të këtyre çështjeve si edhe janë gjeneruar iniciativa të tjera që mbështetin zbatimin dhe qëndrueshmërinë e programit “Ndikimi i Politikëbërjes.”



OBJEKTIVAT DHE TREGUESIT E ARRITJES

OBJEKTIVI 1

Fuqizimi i kapaciteteve të brendshme të Co-PLAN në drejtim të Punës Kërkimore të Aplikuar për Politika Publike qendrore dhe lokale

Treguesit e Arritjes






- ❖ Katër studime kërkimore të përgatitura nga ekipi i Co-PLAN me temat përkatëse bazuar në subjektet e mësipërme;
- ❖ Pesë ekspertë të Co-PLAN të angazhuar drejtpërdrejt në procesin kërkimor;
- ❖ Pjesëmarrja e stafit të Co-PLAN në 5 aktivitete dhe kurse ndërkombëtare: “Intergovernmental fiscal relations and local financial management” organizuar nga CEU Budapest; “In-depth course in Public Finance Management”, Suedi; “53rd IFHP World Congress”, Berlin; “EU Environmental Forum and Policy Summit”, Bruksel; “SEE Adriatic Coastline workshop” Mal i Zi;
- ❖ 6 projekt-propozime, përgatitur në kuadër të njohurive të programit dhe aprovuar nga donatorët (MATRA, LGPA USAID, EU, UNDP);
- ❖ 12 takime në nivel qarku për reformën territoriale dhe rajonalizimin.
- ❖ Co-PLAN është abonuar në 5 revista periodike ndërkombëtare profesionale dhe ka marrë botimet e 20 viteve të fundit të dy prej tyre;
- ❖ Biblioteka e Co-PLAN/POLIS është pasuruar me mbi 60 tituj të rinj që lidhen me temat e mbuluara nga projekti.

OBJEKTIVI 2

Ndikimi i politikave publike në fushat përkatëse përmes zgjerimit të rrjetit të partnerëve dhe grupeve të interesit nga fusha akademike dhe e politikave publike dhe shpërndarjes së njohurive

Treguesit e Arritjes

- ❖ Tre dokumente politikash u janë paraqitur ministrive të linjës dhe rrjetit të partnerëve;
- ❖ Një leksion i Guvernatorit të Bankës së Shqipërisë u organizua nga Co-PLAN në bashkëpunim me Universitetin POLIS mbi temën: “Sfidat e Shqipërisë në erën e krizës globale ekonomike – Industria e Ndërtimit dhe Tregu i Pasurive të Patundshme në Shqipëri”;
- ❖ Co-PLAN, në bashkëpunim me Ministrinë e Mjedisit, Ministrinë e Punëve Publike, SHBSH, Grontmij Carl Bro dhe USAID, organizoi një konferencë kombëtare mbi Menaxhimin e Integruar të Mbeturinave të Ngurta;
- ❖ Dokumenti i Politikave për Rajonalizimin e Shqipërisë dhe Reformën Territoriale u publikua nga Universiteti POLIS në “Forum A+P”.



Asistencë teknike për njësitë e qeverisjes vendore Fushë-Arrëz, Vau i Dejës & Guri i Zi në kthimin e PSZh në instrumente dhe procese planifikimi dhe buxhetimi bashkiak nëpërmjet përmirësimit të praktikave të menaxhimit financiar

Koha e Zbatimit: Tetor 2009 - Dhjetor 2009

Donatori: DLDP financiar nga Agjencia Zvicerane për Zhvillim (SDC), zbatuar nga IC në Shqipëri

Fondi: 20, 180 €

Zbatohet në: Bashkia e Fushë-Arrëzit, Bashkia e Vaut të Dejës, Komuna e Gurit të Zi

Në kuadër të Programit për Decentralizimin dhe Zhvillimin Vendor, financiar nga Agjencia Zvicerane për Zhvillim dhe zbatuar nga InterCooperation në Rajonin e Shkodrës, Co-PLAN, Instituti për Zhvillimin e Habitatit, ka asistuar gjashtë njësi të qeverisjes vendore në përgatitjen e Planeve Strategjike të Zhvillimit nëpërmjet një procesi me pjesëmarrje, ndërkohë që dy nga këto NJQV janë asistuar gjithashtu edhe në përgatitjen e Planeve të Përgjithshëm Rregullues, përkatësisht bashkitë e Vaut të Dejës dhe Koplikut. Në vijim të kësaj ndërhyrjeje si dhe duke pasur parasysh nevojat në nivel vendor, në muajin Tetor 2009 projekti pati si synim krijimin e lidhjes mes zbatimit të Planeve Strategjike të Zhvillimit dhe instrumenteve financiare si dhe përkthimin e këtyre Planeve në instrumente të

planifikimit dhe menaxhimit financiar në nivel vendor. Buxheti vjetor, buxhetimi me pjesëmarrje, buxhetet afatmesëm dhe plani i investimeve kapitale janë konsideruar instrumente që duhen prezantuar si mjete për arritjen e qëllimit të synuar. Të gjithë këta instrumente mundësojnë lidhjen e projekteve teknike me burimet e nevojshme financiare; si rrjedhim, kërkohet një ndryshim shumë i madh lidhur me praktikën dhe politikat e menaxhimit të financave vendore. Ndërhyrjet e propozuara kanë adresuar dy çështje kryesore: (i) asistimin e bashkive Fushë-Arrëz e Vau i Dejës dhe të komunës Guri i Zi në hartimin e buxheteve vjetore për vitin 2010, duke ndjekur ndërhyrjet strategjike të parashikuara në Planin Strategjik të Zhvillimit; (ii) rritjen e ndërgjegjes dhe ndërtimin e kapaciteteve të

gjashtë njësive të qeverisjes vendore lidhur me përgatitjen e Planeve të Investimeve Kapitale dhe të Programit për Buxhetin Afatmesëm. Buxheti vjetor është përdorur dhe prezantuar si hapi më konkret dhe i pashmangshëm në vënien në praktikë të planeve strategjike të zhvillimit, në kushtet e mungesës së buxhetit afatmesëm dhe planit të investimeve kapitale, për më tepër kur as koha dhe as kapacitetet për të hartuar këto dokumente brenda vitit financiar nuk janë të mjaftueshme. Nga ana tjetër, udhëzimet për përgatitjen e PBA dhe PIK si instrumentet kryesorë që lidhin PSZH me burimet financiare ishin në qendër të një serie trajnimesh të organizuara me të gjashtë njësitë e qeverisjes vendore të cilat synonin forcimin e kapaciteteve për menaxhimin financiar.



OBJEKTIVAT DHE TREGUESIT E ARRITJES

OBJEKTIVI 1

Të asistojë bashkitë Fushë-Arrëz dhe Vau i Dejës si dhe komunën Guri i Zi në përgatitjen e buxheteve vjetore për vitin 2010 duke ndjekur ndërhyrjet strategjike siç parashikohen në PSZH-të

Treguesit e Arritjes



- ❖ 3 paketa fiskale janë përgatitur, diskutuar dhe miratuar në këshillat vendorë për secilën NjQV
- ❖ 3 dokumente të buxhetit vjetor të mbështetura në kapacitetet fiskale janë përgatitur dhe diskutuar gjatë proceseve me pjesëmarrje si dhe janë dorëzuar dhe miratuar në këshillat vendorë, përkatësisht për NjQV-të Vau i Dejës, Guri i Zi dhe Fushë Arrëz
- ❖ Programi i Buxhetit Afatmesëm është përgatitur, diskutuar dhe miratuar në këshillin vendor në bashkinë e Vaut të Dejës

OBJEKTIVI 2

Të rrisë ndërgjegjen dhe të ndërtojë kapacitetet e gjashtë njësive të qeverisjes vendore lidhur me përgatitjen e Planeve të Investimeve Kapitale dhe Programit për Buxhetin Afatmesëm

Treguesit e Arritjes

- ❖ 10 punonjës të stafit të administratës vendore janë asistuar drejtpërdrejt nëpërmjet trajnimeve në punë për lidhjen e dokumenteve strategjike me instrumentet financiarë (buxhet vjetor; buxhet afatmesëm etj.)
- ❖ 1 workshop u organizua me NjQV-të e synuara lidhur me përgatitjen e PBA ose dokumenteve të tjerë strategjike financiarë
- ❖ 1 workshop u organizua me NjQV-të e synuara për të ndarë, diskutuar dhe përgatitur rekomandimet lidhur me hartimin e PBA në NJQV-të e vogla.



3 Zbatimi i Planit të Përgjithshëm Rregullues nëpërmjet nxitjes së zhvillimit të zonës së Parkut të Automjeteve si një gjenerues zhvillimi për qytetin

Koha e Zbatimit: Shtator 2008 - Maj 2009

Donatori: Programi LGPA i financuar nga USAID dhe zbatuar nga ARD, Inc.


Fondi: Lekë 2, 125, 000 Lekë

Zbatohet në: Bashkia e Fierit

Projekti “Zbatimi i Planit të Përgjithshëm Rregullues nëpërmjet nxitjes së zhvillimit të zonës së Parkut të Automjeteve si një gjenerues zhvillimi për qytetin” filloi të zbatohet në vijim të marrëveshjes së nënshkruar midis Bashkisë së Fierit dhe Programit për Qeverisjen Vendore në Shqipëri në fund të muajit Shtator 2009. Qëllimi i këtij projekti është vënia në zbatim e Partneritetit Publik-Privat (PPP) lidhur me rigjallërimin dhe zhvillimin e zonës së Parkut. Kështu,

Bashkia Fier është asistuar në formulimin e një propozimi të financueshëm për ndërtimin e Terminalit të Autobusëve së bashku me zhvillimin e zonës së banimit dhe shërbimeve përkatëse në këtë zonë. Zhvillimi i ri do të nxisë më tej ekonominë e qytetit nëpërmjet investimeve publike dhe private si dhe do të mundësojë një instrument për zbatimin e Planit të Përgjithshëm Rregullues dhe të Strategjisë së Zhvillimit të qytetit Fier. Qëllimi kryesor është zbrërthyer më tej

në objektiva si më poshtë: të vlerësojë mundësitë e zonës së Parkut për t’u kthyer në një Terminal të Autobusëve të qytetit; (ii) të vlerësojë ndikimin e ndërhyrjes në Nyjën e Patosit; (iii) të shqyrtojë mundësitë për zbatimin e PPP. Produktet kryesore të këtij projekti janë: (i) rivlerësimi dhe përmirësimi i design brief për zonën e Parkut; (ii) analiza financiare dhe skema e PPP dhe (iii) rekomandimet lidhur me skemën e Zbatimit dhe Marketimit.



OBJEKTIVAT DHE TREGUESIT E ARRITJES

OBJEKTIVI 1

Të vlerësojë mundësitë e zonës së Parkut për t'u shndërruar në një Terminal Autobusësh për qytetin

Treguesit e Arritjes	❖ 1 grup pune është ngritur në bashkinë e Fierit për mbledhjen e informacionit dhe organizimin e takimeve me të gjithë aktorët e interesuar ❖ 1 analizë kërkesë për terminalin e autobusëve në bashkinë e Fierit është përgatitur duke u bazuar në informacionin e grumbulluar lidhur me transportin dhe nevoja të tjera lehtësuese për bizneset në qytet ❖ 10 takime janë organizuar me komunitetin e zonës së Parkut, zhvilluesit e interesuar, bizneset që kanë të bëjnë me transportin, pronarët e tokave si dhe me aktorë të tjerë të interesuar në zonë
----------------------	---

OBJEKTIVI 2

Të shqyrtojë mundësitë për zbatimin e PPP

Treguesit e Arritjes	❖ Hartimi i mëparshëm i design brief –it është përditësuar ❖ 2 skenarë për zhvillimin e gjithë zonës së Parkut dhe lidhjes së saj me qytetin janë hartuar ❖ 2 takime janë organizuar me zhvillues të interesuar/pronarët e tokave për të diskutuar ndërhyrjet e propozuara dhe ndikimin në qytet të zgjidhjeve të ndryshme
----------------------	--

OBJEKTIVI 3

To explore possibilities for implementation of a PPP

Treguesit e Arritjes	❖ Një analizë e detajuar fizibiliteti është përgatitur me fokus mundësitë për zbatimin e PPP midis bashkisë së Fierit dhe zhvilluesve të interesuar ❖ 2 skenarë financiarë janë hartuar dhe diskutuar duke u bazuar në propozimet për zhvillimin e zonës ❖ Rekomandime lidhur me rregullimet institucionale dhe tregun janë përgatitur dhe janë diskutuar në një takim të përbashkët mes bashkisë së Fierit dhe zhvilluesve
----------------------	---

4 Studim Fizibiliteti për Ngritjen e një zone industriale në Lezhë

Koha e Zbatimit: Shtator 2009 - Prill 2010

Donatori: Programi për Qeverisjen Vendore në Shqipëri, financuar nga USAID, zbatuar nga ARD inc.

Fondi: Lekë 1, 958, 000 Lekë




Zbatohet në: Bashkia e Lezhës



Projekti “Studim Fizibiliteti për Ngritjen e një zone industriale në Lezhë” filloi zbatimin e tij në vijim të marrëveshjes së nënshkruar midis bashkisë Lezhë dhe Programit për Qeverisjen Vendore në Shqipëri (LGPA) në fund të muajit Tetor 2009. Ky projekt synon të shërbejë si një instrument për të udhëhequr procesin e vendimmarrjes brenda bashkisë lidhur me investimet private dhe për t’i harmonizuar

ato në mënyrë të përshtatshme me projektet potenciale për investime në sektorin publik. Studimi i fizibilitetit do të ofrojë një bazë për zhvillimin e një studimi të detajuar urban të zonës industriale si dhe të një dokumenti zyrtar të Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis. Ky studim synon të orientojë zhvillimin e qëndrueshëm ekonomik dhe fizik të qytetit të Lezhës në përputhje me sfidat aktuale të zhvillimit,

kërkesat ekonomike për hapësira industriale dhe nismat dhe projektet e zhvillimit për infrastrukturën rajonale dhe vendore. Objektivat kryesorë të projektit për vitin 2009 janë: i) Të grumbullojë të gjithë informacionin e nevojshëm mbi zonën industriale dhe (ii) Të fillojë hartimin e një analize hapësinore dhe një analize të gjendjes fizike për zonën e propozuar industriale



OBJEKTIVAT DHE TREGUESIT E ARRITJES

OBJEKTIVI 1

Të grumbullojë të gjithë informacionin e nevojshëm mbi zonën industriale

Treguesit
e Arritjes




- ❖ 6 takime u organizuan me grupin e punës, të përbërë nga METE, ALBINVEST, ANTRACO, GRD/MPPTT dhe Qarku i Lezhës
- ❖ Harta e pronësisë dhe informacioni përkatës u përditësuan së bashku me grupin e punës
- ❖ 2 takime koordinuese dhe takime të tjera u organizuan me përfaqësues të Ndërmarrjes së Ujësjetllësit, KESH, AlbTelecom etj...

OBJEKTIVI 2

Të hartojë një analizë hapësinore dhe një analizë të gjendjes fizike për zonën e propozuar industriale

Treguesit
e Arritjes

- ❖ 2 takime u organizuan me grupin e punës për të diskutuar mbi analizën hapësinore dhe atë të gjendjes fizike
- ❖ 8 harta tematike u përgatitën për të paraqitur analizën hapësinore dhe atë të gjendjes fizike ku u theksuan avantazhet dhe disavantazhet e vendndodhjes si dhe faktorë të tjerë



5 *Fuqizimi i Performancës Mjedisore në Nivel Vendor nëpërmjet Menaxhimit të Mbetjeve Bashkiake në Fier si model pilot*

Koha e Zbatimit: Dhjetor 2008 - Dhjetor 2010

Donatori: Ambasada e Vendeve të Ulëta

Fondi: € 467,281

Zbatohet në: Bashkia Fier


Reforma e decentralizimit të qeverisjes filloi si nevojë për t'u përballur më mirë me ofrimin e shërbimeve në nivel vendor. Kjo gjë kërkoi nga qeverisja qendrore që të hiqte dorë nga pozicioni i ofruesit të drejtpërdrejtë të shërbimeve në politikëbërje, duke i bërë të mundur qeverisjes vendore të merrte mbi vete këtë përgjegjësi. Zbatimi i reformës që mbështet si decentralizimin politik ashtu dhe atë fiskal është ende në vazhdim ndërkohë që është duke hasur sfida të ndryshme si pasojë e kapaciteteve të ulëta administrative në nivel vendor dhe e legjislacionit përkatës. Ndërkohë që procesi i decentralizimit është duke hyrë në një fazë konsolidimi, stafi i administratës vendore dhe vendimmarrësit kanë ende nevojë për njohuri profesionale dhe aftësi praktike lidhur me mënyrën se si do të përdoren instrumentet ekzistues si edhe me

ndarjen e mjeteve dhe eksperiencave me njëritjetrin.

Përveç çka u përmend më sipër, vendi është duke u përballur më shumë probleme mjedisore të cilat në disa raste sa vijnë e porriten si p.sh. cilësia e dobët e ajrit, cilësia e dobët dhe furnizimi i kufizuar me ujë të pijshëm, trajtimi i pamjaftueshëm i ujërave të zeza, mungesa e higjienës publike, zhvillimi urban kaotik, shpyllëzimi dhe degradimi i tokës. Në mënyrë të veçantë zonat rurale dhe qytetet janë duke u përkeqësuar për shkak të cilësisë së dobët të menaxhimit të mbetjeve urbane të ngurta.

Në këtë kuadër, duke marrë në konsideratë eksperiencat e fituara nga programe të tjera si edhe nevojat e njësive të qeverisjes vendore në Shqipëri, Co-PLAN e gjykon thelbësore vazhdimësinë e punës për fuqizimin e pushtetit

vendor në Shqipëri. Projekti “Fuqizimi i Performancës Mjedisore në Nivel Vendor nëpërmjet Menaxhimit të Mbetjeve Bashkiake në Fier si model pilot” është një program 2-vjeçar i cili është fokusuar në bashkinë e Fierit, ku mundësitë tashmë janë ndërtuar dhe ku gjithashtu janë shfaqur nisma të orientuara nga kërkesa. Ky projekt synon: përmirësimin e performancës së Ndërmarrjes së Pastrim-Gjelbërimit dhe Departamentit të Shërbimeve Publike në bashkinë Fier nëpërmjet Skemave të Menaxhimit për Auditimin Ekologjik, ofrimin e mbështetjes institucionale ndaj bashkisë me qëllim përmirësimin e shërbimit për menaxhimin e mbetjeve të ngurta, përmirësimin e infrastrukturës së shërbimit për mbetjet e ngurta urbane nëpërmjet investimeve të drejtpërdrejta të bashkëfinancuara edhe nga bashkia.



OBJEKTIVAT DHE TREGUESIT E ARRITJES

OBJEKTIVI 1

Të përmirësojë performancën e menaxhimit mjedisor të Ndërmarrjes së Pastrim-Gjelbërimit dhe Departamentit të Shërbimeve Publike në Bashkinë Fier

Treguesit e Arritjes



- ❖ Nënshkrimi i Memorandumit të Bashkëpunimit dhe ngritja e grupit të punës si dhe e një komiteti konsultativ në bashkinë Fier
- ❖ Organizimi i një serie takimesh me grupin e punës për mbledhjen e informacionit lidhur me gjendjen ekzistuese të menaxhimit të mbetjeve të ngurta urbane në bashkinë Fier si dhe vlerësimin e mjedisit në të cilin vepron Ndërmarrja e Pastrim-Gjelbërimit
- ❖ Organizimi i takimit të parë me bordin këshillues dhe prezantimi i gjetjeve lidhur me situatën aktuale të ofrimit të shërbimit për mbetjet e ngurta urbane
- ❖ Realizimi i një studimi fillestar mjedisor që shërbeu për të identifikuar të gjitha ndikimet mjedisore të aktivitetit të Ndërmarrjes së Pastrim-Gjelbërimit si dhe për të theksuar rëndësinë e tyre
- ❖ Kryerja e studimit për analizën institucionale të Ndërmarrjes së Pastrim-Gjelbërimit
- ❖ Kryerja e dy vëzhgimeve studimore për matjen e opinionit të qytetarëve dhe bizneseve lidhur me cilësinë e shërbimit të pastrimit dhe menaxhimit të mbetjeve në bashkinë Fier
- ❖ Kryerja e auditimit financiar të Ndërmarrjes së Pastrim-Gjelbërimit për vlerësimin e efikasitetit të ofrimit të shërbimit
- ❖ Hartimi dhe ofrimi në publik i Deklaratës Mjedisore



OBJEKTIVI 2

Të përmirësojë shërbimin ekzistues të Menaxhimit të Mbetjeve të Ngurta në Bashkinë Fier duke ndërtuar një strategji dhe një plan veprimi për të ardhmen

Treguesit e Arritjes

- ❖ Organizimi i 2 seminareve me stafin e Ndërmarrjes së Pastrim-Gjelbërimit, grupin e punës dhe komitetin konsultativ në bashkinë Fier
- ❖ Zhvillimi i Kuadrit strategjik të metodologjisë për planin e menaxhimit të mbetjeve urbane dhe fillimi i procesit të planifikimit
- ❖ Kryerja e një studimi bazë si hapi i parë për hartimin e Planit të Menaxhimit të Mbetjeve të Ngurta Urbane
- ❖ Organizimi i 2 trajnimeve (një teorik dhe një praktik) me stafin e Ndërmarrjes së Pastrim-Gjelbërimit mbi procesin e ndarjes së mbeturinave
- ❖ Kryerja e 2 fushatave lidhur me ndarjen e mbeturinave, për të identifikuar përbërjen e tyre si dhe potencialet për riciklim pas derdhjes
- ❖ Organizimi i 5 takimeve me grupe të ndryshme interesi për hartimin e Vizionit, Misionit dhe Objektivave të Planit Strategjik të Mbetjeve të Ngurta Urbane





OBJEKTIVI 3

Të shpërndajë eksperiencat e fituara në mënyrë të tillë që të zgjojë interesin e njësive të tjera të qeverisjes vendore dhe t'i sfidojë e inkurajojë ato lidhur me minimizimin e ndikimeve në mjedis të aktivitetit të tyre

Treguesit e Arritjes	❖ Organizimi i Tryezës Kombëtare mbi Sektorin e Menaxhimit të Mbetjeve për të identifikuar dhe adresuar çështjet problematike aktuale që shqetësojnë autoritetet vendore si edhe për të shpërndarë më tej eksperiencën e projektit ❖ Organizimi i Seminarit mbi Studimin e Ndarjes së Mbeturinave për të përhapur më tej rëndësinë e procesit të ndarjes së mbeturinave dhe gjetjet e studimit mbi ndarjen e tyre ❖ Botimi i 3 artikujve në gazetën “Ekolëvizja” dhe “Mjedisi Sot”
----------------------	--

OBJEKTIVI 4

Të përmirësojë infrastrukturën për përmirësimin e shërbimit të mbetjeve të ngurta urbane nëpërmjet investimeve konkrete të bashkëfinancuara nga bashkia

Treguesit e Arritjes	❖ 3 takime u realizuan me grupin e punës për identifikimin e fushave që kanë nevojë për ndërhyrje në infrastrukturë ❖ 1 analizë financiare e detajuar është kryer dhe janë nxjerrë përfundimet lidhur me fushat ku do të kryhen investimet
----------------------	---

6 Taksa e Pasurisë - një instrument për financimin novator në nivel vendor në Shqipëri

Koha e Zbatimit: Tetor 2009 - Shtator 2010

Donatori: Programi LGPA i financuar nga USAID dhe zbatuar nga ARD, Inc.

Fondi: Lekë 1, 920, 350 Lekë

Zbatohet në: Rasteve studimore dhe grumbullimit të informacionit në 10 njësi të qeverisjes vendore

Projekti “Taksa e Pasurisë - një instrument për financimin novator në nivel vendor në Shqipëri” ka filluar të zbatohet në Tetor 2009. Projekti është hartuar në formën e një studimi kërkimor të ndërmarrë për të analizuar alternativa novatore të financimit të cilat mund të vihen në përdorim si instrumente që i përgjigjen nevojës në rritje për fonde në infrastrukturë. Ky studim fokusohet në rolin e rëndësishëm rregullator që mund të luajnë bashkitë në procesin e administrimit të tokës nëpërmjet “përdorimit me vend” të taksës së

pasurisë në nivel vendor.

Studimi është parë në këndvështrimin e trajtimit të 2 komponentëve kryesorë: (i) së pari, të mënyrave novatore që mund të adoptohen nga njësitë e qeverisjes vendore për sa i përket sektorit të strehimit për të gjeneruar më shumë të ardhura lidhur me nevojat për investime kapitale në qytete (ii) dhe, së dyti, të rekomandimeve për politika në institucionet publike, si në nivelin qendror ashtu dhe në atë vendor, mbi përdorimin e taksës së pasurisë si një instrument që udhëheq administrimin

dhe përdorimin e tokës në Shqipëri.

Rekomandimet për politika do të shoqërohen edhe me një plan veprimi i cili do të orientojë njësitë e qeverisjes vendore drejt një administrimi dhe menaxhimi më të mirë të këtyre taksave duke çuar në rritjen e grumbullimit të tyre. Gjatë vitit 2009, objektivat kryesorë të këtij projekti kërkimor konsistuan në: (i) hartimin e metodologjisë së studimit; (ii) grumbullimin e informacionit cilësor dhe sasior lidhur me këtë çështje; (iii) analizimin e informacionit dhe të dhënave të grumbulluara.



OBJEKTIVAT DHE TREGUESIT E ARRITJES

OBJEKTIVI 1


Të mbledhë informacion cilësor dhe sasior lidhur me çështjen

Treguesit e Arritjes	❖ Metodologjia e studimit u hartua dhe miratua ❖ Një vëzhgim “në zyrë” u realizua me sukses, duke u mbështetur në informacionin e grumbulluar nga hartat ajrore/ortofotot historike dhe ato të përditësuara për 10 qytete (Shkodër, Lezhë, Tiranë, Durrës, Elbasan, Fier, Lushnjë, Vlorë, Korçë dhe Sarandë) ❖ Një bazë të dhënash mbi informacionin e grumbulluar nga vëzhgimi i realizuar u projektua dhe u përgatit në sistemin GIS ❖ 15 intervista dhe takime lidhur me taksën e pasurisë u organizuan me përfaqësues të lartë nga 8 bashki të ndryshme (Fier, Lezhë, Durrës, Shkodër, Korçë, Berat, Kukës dhe Fushë-Krujë) ❖ Një takim lidhur me subjektin e studimit kërkimor u organizua me përfaqësues të lartë të Ministrisë së Financave
----------------------	--

OBJEKTIVI 2

Të analizojë informacionin dhe të dhënat e grumbulluara

Treguesit e Arritjes	❖ Një bazë të dhënash u hartua dhe u përgatit në sistemin GIS për të analizuar të gjithë informacionin e grumbulluar nga vëzhgimi “në zyrë” ❖ Mbi 60 harta dhe propozime tematike të sintetizuara u përgatitën duke u mbështetur në analizën e informacionit ❖ 5 dokumente janë hartuar lidhur me situatën e administrimit dhe menaxhimit të taksës mbi ndërtesën në nivel vendor
----------------------	---



7 Delta - Vazhdimësia e mbështetjes në bashkitë e përzgjedhura (Berat, Durrës, Lezhë, Korçë dhe Shkodër) - Plani i Investimeve Kapitale

Koha e Zbatimit: 25 Shkurt 2009 - 25 Shkurt 2010, i shtrirë deri në Korrik 2010

Donatori: Fondacioni i Institutit për Shoqërinë e Hapur (OSI-ZUG)

Fondi: USD 74,317

Zbatohet në: Bashkia e Beratit, Durrësit, Lezhës, Korçës dhe Shkodrës

Në kuadër të programit DELTA (Zhvillimi i Ekonomive Vendore nëpërmjet Aksionit dhe Aleancës), pesë bashki të Shqipërisë, përkatësisht ato të Beratit, Durrësit, Lezhës, Korçës dhe Shkodrës, u asistuan në përgatitjen e planeve të tyre strategjike nëpërmjet proceseve me pjesëmarrje. Në fillim të vitit 2008, Fondacioni i Institutit për Shoqërinë e Hapur miratoi një projekt-propozim 2-vjeçar të paraqitur nga Co-PLAN për një vazhdimësi të projektit në Bashkitë DELTA, projekt ky i cili synon konsolidimin e kapaciteteve bashkiake për të punuar me Planet Strategjike

të Zhvillimit Ekonomik Vendor duke vënë në përdorim Planin e Investimit Kapital (PIK) si një instrument që do të mundësojë vënien në praktikë të PZhEV. Ndërkohë që gjatë vitit 2008 projekti u fokusua në ngritjen e kapaciteteve dhe rritjen e ndërgjegjësimit lidhur me çështjet e financave bashkiake, në vitin 2009, ekspertët e Co-PLAN asistuan stafet vendore në përkthimin e strategjive të qytetit në projekte të financueshme dhe të zbatueshme nëpërmjet lançimit të PIK. Qëllimi kryesor i këtij projekti është zbërthyer në objektiva si më poshtë vijon: (i) të ngrejë kapacitetet vendore

të këtyre qyteteve për të punuar si dhe për të maksimalizuar mundësinë e përdorimit të Ligjit mbi Huamarrjen Vendore; (ii) të asistojë stafin vendor në maksimalizimin e potencialit të taksave vendore; (iii) të ngrejë kapacitetet vendore lidhur me menaxhimin financiar dhe atë fiskal; (iv) të ngrejë kapacitetet vendore në përgatitjen e Planeve për Investime Kapitale (CIP); (v) të hartojë një PIK të zbatueshëm në secilin qytet; (vi) të ndërtojë praktika të reja të menaxhimit financiar; (vii) të përcaktojë indikatorët mbi bazën e të cilëve do të kryhet rishikimi vjetor i PIK.



OBJEKTIVAT DHE TREGUESIT E ARRITJES

OBJEKTIVI 1

Të ngrejë kapacitetet vendore të këtyre qyteteve për të punuar si dhe për të maksimalizuar mundësinë e përdorimit të Ligjit mbi Huamarrjen Vendore

Treguesit e Arritjes


- ❖ Një analizë e mundësive për huamarrje u përgatit për secilën nga bashkitë e Korçës, Shkodrës dhe Beratit
- ❖ 5 takime koordinuese u organizuan me institucionet bankare dhe bashkinë Korçë mbi mundësinë për huamarrje vendore
- ❖ 10 punonjës të administratës vendore u trajnuan nëpërmjet ofrimit të asistencës në punë lidhur me çështjet e huamarrjes vendore

OBJEKTIVI 2

Të asistojë stafin vendor në maksimalizimin e potencialit të taksave të vendore

Treguesit e Arritjes

- ❖ 3 analiza mbi administrimin dhe menaxhimin e taksës së ndërtesës në nivel vendor janë përgatitur në secilën prej njësive vendore të synuara (Korçë, Shkodër, Berat)
- ❖ 3 plane veprimi dhe dokumente të tjerë me rekomandime u hartuan mbi subjektin “Si të përmirësojmë mbledhjen dhe administrimin e taksës vendore të ndërtesës” në secilën prej njësive vendore të synuara (Korçë, Shkodër, Berat)





A BERAT


Emertimi

	Vitet						
	2006	2007	2008	2009	2010	2011	2012
ndore	99504	99196	110705	139035	130806	143887	158276
ndore	29587	31387	35334	52489	38492	44333	48766
jo tatimore	31958	29532	20660	51998	83212	55960	59056
e Pakushtezuar	119247	144610	135678	160580	159898	164695	176224
tal	280040	295725	302377	404102	412408	408875	442322
operative & Mirembajtje	259850	262053	276108	303944	345118	358863	376731
itale	20190	33672	26269	100158	67290	50012	65591




ngas natyres se te ardhurave

Trendi te ardhurave nga taksat



Raporti shpenzimeve kapitale/...



OBJEKTIVI 3

Të ngrejë kapacitetet vendore lidhur me menaxhimin financiar dhe atë fiskal

Treguesit e Arritjes	❖ 20 punonjës të administratës vendore janë trajnuar nëpërmjet ofrimit të asistencës në punë dhe trajnimeve në punë lidhur me aftësitë në menaxhimin financiar (analiza financiare dhe fiskale, potencialet e huamarrjes, mbledhja e të ardhurave vendore) ❖ 20 organizata të shoqërisë civile u trajnuan lidhur me monitorimin dhe përditësimin e planit të investimeve kapitale
----------------------	--

OBJEKTIVI 4

Të hartojë një PIK të zbatueshëm në secilin qytet

Treguesit e Arritjes	❖ 3 Plane të Investimeve Kapitale u hartuan në bashkitë Korçë, Shkodër dhe Berat ❖ 3 takime me këshillat vendorë u organizuan me qëllim diskutimin e PIK në qytetet Korçë, Shkodër dhe Berat
----------------------	---

OBJEKTIVI 5

Të përcaktojë indikatorët mbi bazën e të cilëve do të kryhet rishikimi vjetor i PIK

Treguesit e Arritjes	❖ Një metodologji për monitorimin dhe përditësimin e PIK u përgatit, u diskutua dhe u dorëzua pranë njësive vendore ❖ PIK në Lezhë dhe Durrës u monitoruan duke u bazuar në metodologjinë e hartuar ❖ Manuali për hartimin e PIK në nivel vendor u përditësua dhe një aneks me treguesit për monitorimin dhe rishikimin e PIK u përfshi në këtë dokument
----------------------	--

8 Planifikimi i Investimeve Kapitale në Bashkitë e Kukësit & Fushë-Krujës

Koha e Zbatimit: Janar 2009 - Dhjetor 2009

Donatori: Programi për Qeverisjen Vendore në Shqipëri, financuar nga USAID, zbatuar nga ARD inc.


Fondi: Lekë 8, 626, 077 Lekë

Zbatohet në: Bashkia e Kukësit, Bashkia e Fushë-Krujës


Projekti “Planifikimi i Investimeve Kapitale në Bashkitë e Kukësit & Fushë-Krujës” nisi zbatimin e tij në bashkitë Kukës dhe Fushë-Krujë që prej Janarit 2009. Qëllimi kryesor i këtij projekti

është të asistojë njësitë e qeverisjes vendore me mekanizmat financiarë. Objektivi kryesor i në zhvillimin e instrumenteve strategjike projektit është ngritja e kapaciteteve vendore të buxhetimit me qëllim harmonizimin e për zhvillimin dhe menaxhimin e buxheteve objektiveve strategjike të zhvillimit të qytetit për investime kapitale.



Trendi te ardhurave nga taksat



Te ardhura sipas natyres / buxhetit



Trendi Shpenzimeve Kapitale



OBJEKTIVAT DHE TREGUESIT EARRITJES

OBJEKTIVI 1

Ngritja e kapaciteteve vendore në qytete për zhvillimin dhe menaxhimin e buxheteve për investime kapitale

Treguesit
e Arritjes

- ❖ 15 punonjës të administratës vendore janë trajnuar nëpërmjet asistencës në punë dhe trajnimeve lidhur me përgatitjen e programeve për investime kapitale si në bashkinë Kukës ashtu dhe në atë Fushë-Krujë
- ❖ 6 punonjës të administratës vendore janë asistuar gjatë përgatitjes së dokumenteve të analizës financiare dhe politikës fiskale në të dy këto njësi të qeverisjes vendore

OBJEKTIVI 2

Të asistojë stafin e administratës vendore në përmirësimin e të ardhurave vendore nëpërmjet mbledhjes së taksave

Treguesit
e Arritjes

- ❖ 2 analiza me fokus ngritjen e sistemit për administrimin dhe menaxhimin e taksave në nivel vendor janë përgatitur në secilën njësi vendore, përkatësisht të Kukësit dhe të Fushë-Krujës
- ❖ 2 plane veprimi si dhe dokumente të tjerë me rekomandime me subjekt “Si të përmirësojmë mbledhjen dhe administrimin e taksës vendore mbi ndërtesën” janë hartuar në secilën prej njësive vendore Kukës dhe Fushë-Krujë

OBJEKTIVI 3

Të hartojë një Plan të zbatueshëm të Investimeve Kapitale për secilin qytet

Treguesit
e Arritjes

- ❖ Një metodologji për hartimin e planeve të investimeve kapitale u përgatit
- ❖ Planet e Investimeve Kapitale u hartuan në secilën prej njësive vendore Kukës dhe Fushë-Krujë
- ❖ Një seri takimesh janë organizuar me këshillat vendorë për diskutimin dhe miratimin e PIK në qytetet Kukës dhe Fushë-Krujë

OBJEKTIVI 4

Të përmirësojë praktikatat e menaxhimit financiar në nivel vendor

Treguesit
e Arritjes

- ❖ Një dokument metodologjie për analizimin e kapaciteteve fiskale të bashkisë u përgatit
- ❖ Vlerësimi i mundësive për huamarrje u realizua në secilën prej bashkive Kukës dhe Fushë-Krujë





9 Hartimi i Planit të Përgjithshëm Rregullues të Kukësit


Koha e Zbatimit: Janar 2009 - Prill 2010

Donatori: USAID Bashkia Kukës

Fondi: 10,455,000 Lekë

Zbatohet në: Bashkia e Kukësit

Plani i Përgjithshëm Rregullues i qytetit të Kukësit, pjesë e Programit LGPA të financuar nga USAID dhe të zbatuar nga ARD, do të jetë një instrument i fuqishëm që do të udhëheqë investimet private në këtë bashki dhe do t'i sjellë këto zhvillime në një linjë me projektet për investime të sektorit publik. Co-PLAN, si partneri lokal i LGPA-së, është duke punuar ngushtësisht me Bashkinë e Kukësit për të siguruar asistencën teknike në procesin e përgatitjes së Planit Urban Rregullues. Ky Plan synon të orientojë një zhvillim fizik dhe ekonomik të qëndrueshëm të qytetit të Kukësit në përputhje me sfidat aktuale të zhvillimit si dhe projektet dhe iniciativat e tjera rajonale. Gjithashtu, ky Plan do të udhëheqë zhvillimet ekonomike dhe do ta vendosë Kukësin në pozicionin e një qendre urbane vitale dhe të një korridori kalimi kombëtar nga Shqipëria në Kosovë dhe anasjelltas. Procesi i punës u mbështet në bashkëpunimin me njësinë vendore nëpërmjet ngritjes së një Grupi Pune me përgjegjësi të përcaktuara qartë.



OBJEKTIVAT DHE TREGUESIT E ARRITJES

OBJEKTIVI 1

Hartimi i Detyrës së Projektimit për Planin e Përgjithshëm Rregullues të qytetit të Kukësit

Treguesit
e Arritjes

- ❖ Një studim social-ekonomik i qytetit të Kukësit bazuar në 250 pyetësorë të shpërndarë nëpër familje
- ❖ Krijimi i një baze të dhënash bazuar mbi analizën e situatës
- ❖ Departamente, institucione dhe ndërmarrje vendase të intervistuar
- ❖ 31 harta tematike
- ❖ Miratimi i Detyrës së Projektimit në nivelin lokal dhe atë qendror

OBJEKTIVI 2

Hartimi i Planit të Përgjithshëm Rregullues të qytetit të Kukësit

Treguesit
e Arritjes




- ❖ 2 seminare u zhvilluan në këtë fazë të projektit, ku u diskutua mbi format dhe drejtimet e transformimit të territorit urban dhe zonës përreth
- ❖ 5 takime me grupet e punës janë organizuar me qëllim diskutimin e elementeve të propozimeve territoriale
- ❖ Janë në proces përgatitjeje hartat tematike

OBJEKTIVI 3

Hartimi i Vlerësimit Strategjik Mjedisor

Treguesit
e Arritjes

- ❖ Është kryer analiza e gjendjes ekzistuese të ndotjes në ajër, tokë dhe ujë




Hartimi i Planit të Përgjithshëm Rregullues të Bashkisë Fushë-Krujë

Koha e Zbatimit: Tetor 2008 - Prill 2010


Donatori: USAID / Bashkia Fushë-Krujë

Fondi: 10,455,000 Lekë

Zbatohet në: Bashkia Fushë-Krujë



Plani i Përgjithshëm Rregullues i qytetit të Fushë-Krujës, pjesë e Programit LGPA të financuar nga USAID dhe të zbatuar nga ARD, do të jetë një instrument i fuqishëm që do të udhëheqë investimet private në këtë bashki dhe do të sjellë në një linjë këto zhvillime me projektet për investime të sektorit publik. Co-PLAN, si partneri lokal i LGPA-së, është duke punuar ngushtësisht me Bashkinë e Fushë-Krujës për të ofruar asistencën teknike në procesin e përgatitjes së Planit të Përgjithshëm Rregullues të qytetit. Ky Plan synon të orientojë drejt një zhvillimi fizik dhe ekonomik të qëndrueshëm të qytetit të Fushë-Krujës, në përputhje me sfidat aktuale të zhvillimit dhe me projektet dhe iniciativat e tjera rajonale. Gjithashtu, ky Plan do të udhëheqë zhvillimet ekonomike dhe do ta vendosë Fushë-Krujën në pozicionin e një qendre urbane të rëndësishme në rajonin Tiranë-Durrës. Procesi i punës u mbështet në bashkëpunimin me njësinë vendore, nëpërmjet ngritjes së Grupit të Punës me përgjegjësi të përcaktuara qartë.



OBJEKTIVAT DHE TREGUESIT E ARRITJES

OBJEKTIVI 1

Hartimi Detyrës së Projektimit të Planit të Përgjithshëm Rregullues të qytetit të Fushë-Krujës

Treguesit
e Arritjes

- ❖ 1 seminar u zhvillua në këtë fazë të projektit ku u diskutua mbi format dhe drejtimet e transformimit të territorit urban dhe zonës përreth
- ❖ 4 takime me grupet e punës janë organizuar me qëllim diskutimin e elementeve të propozimeve territoriale të planit
- ❖ Janë ideuar 29 draft-harta tematike të Planit
- ❖ Janë ideuar projekt-ide të infrastrukturave inxhinierike

OBJEKTIVI 2

Hartimi i Planit të Përgjithshëm Rregullues të qytetit të Fushë-Krujës

Treguesit
e Arritjes


- ❖ A workshop was organized in which participants discussed development trends in the urban and rural areas of the municipality;
- ❖ Four working group meeting were organized to discuss territorial aspects of proposed plans;
- ❖ Twenty-nine thematic maps were designed;
- ❖ Design project ideas for engineering infrastructural networks were generated

OBJEKTIVI 3

Hartimi i Vlerësimit Strategjik Mjedisor

Treguesit
e Arritjes

- ❖ Analizë e përgjithshme e gjendjes ekzistuese dhe problematikës mjedisore si ndotja e ajrit, e tokës, e ujit; biodiversiteti etj.
- ❖ Përcaktimi i Metodologjisë për hartimin e Vlerësimit Strategjik Mjedisor
- ❖ Kryerja e vlerësimit mjedisor në lidhje me propozimet e planit
- ❖ Përcaktimi i fazave të monitorimit dhe indikatorëve
- ❖ Ideimi i 2 hartave tematike për problematikën mjedisore
- ❖ Përgatitja e 2 hartave tematike në lidhje me problematikën mjedisore



Zbatimi i Planit Kombëtar për përafrimin e Legjislacionit të Mjedisit në Shqipëri – Studimi për Ndarjen e Mbeturinave në Shqipëri

Koha e Zbatimit: Shtator 2009 - Dhjetor 2009

Donatori: Komisioni Evropian, zbatuar nga Grontmij Carl Bro & Agrotec (Itali)

Fondi: € 29,965

Zbatohet në: Bashkia e Tiranës, Durrësit, Shkodrës, Lezhës, Lushnjës, Beratit, Fushë-Krujës, Fierit dhe Vorës

Ndarja e mbeturinave është një mjet gjerësisht i përdorur për të mbledhur informacionin që nevojitet për planifikimin e menaxhimit të mbetjeve urbane dhe për rritjen e efikasitetit dhe efektivitetit të ofrimit të shërbimit të pastrimit. Pavarësisht përpjekjeve të bëra në këtë drejtim në Evropë, analizat e ndarjes së mbeturinave në vend mungojnë ose janë kryer në mënyrë të pjesshme dhe nuk kanë ndjekur standardet e kohës. Gjithashtu, studimet sporadike të mëparshme kanë qenë të hartuara duke u bazuar në projektet rast pas rasti, gjë që ka çuar në rezultate jo të kënaqshme dhe e ka bërë të vështirë krahasimin e efekteve të masave të ndryshme që janë marrë lidhur me menaxhimin e mbeturinave.

Sot në Shqipëri, kërkesa për statistika të sakta të menaxhimit të mbetjeve buron kryesisht nga nevoja për të ngritur Planin Kombëtar të Menaxhimit të Mbetjeve, duke plotësuar kështu kërkesat e Direktivave të ndryshme

të BE-së. Përveç kësaj, të dhëna nga niveli i qeverisjes vendore nevojiten për formulimin, zbatimin dhe monitorimin e strategjive të menaxhimit të mbetjeve urbane në nivel vendor.





Për herë të parë, Co-PLAN (Instituti për Zhvillimin e Habitatit) e ka përfunduar me sukses analizën e ndarjes së mbeturinave urbane në përputhje me metodologjinë që plotëson standardet Evropiane në qytetin e Fierit. Ky aktivitet u realizua në bashkëpunim me bashkinë e Fierit në kuadër të projektit “Fuqizimi i Performancës Mjedisore në nivel vendor”, financuar nga Ambasada e Mbretërisë së Vendeve të Ulëta.

Kohët e fundit, në kuadrin e projektit “Zbatimi i Planit Kombëtar për përafrimin e Legjislacionit të Mjedisit në Shqipëri”, financuar nga Bashkimi Evropian si pjesë e ndihmës së huaj, Programi CARDS 2006, (dmth programi cards dhe misnitria po përgatisin ??) Ministria e Mjedisit, Pyjeve

dhe Administrimit të Ujërave është duke përgatitur Planin Kombëtar të Menaxhimit të Mbetjeve.

Në kuadrin e këtij projekti të BE-së, i cili po zbatohet nga një consortium (partneritet???) mes kompanisë Grontmij | Carl Bro (Denmark) dhe Agrotec (Itali), Co-PLAN u kontraktua për të ofruar asistencë teknike në identifikimin e përbërjes së mbetjeve në 9 qytete të Shqipërisë, përkatësisht Tiranë, Durrës, Shkodër, Lezhë, Lushnjë, Berat, Fushë-Krujë, Vorë dhe Fier.

Ky studim vëzhgues për auditimin e mbetjeve është i pari i këtij lloji që ndërmerret në nivelin bashkiak me objektiv kryesor përcaktimin e përbërjes së secilës prej shtatëmbëdhjetë kategorive të mbetjeve që shkojnë në vendet e depozitimit (ku aktualisht depozitohen pa asnjë kontroll) në 9 bashkitë e përzgjedhura në gjithë vendin. Gjithashtu, janë ofruar fakteve dhe vlerësimeve të ndryshme lidhur me sasinë e mbetjeve, duke qenë se nuk ka pasur të dhëna të sakta në këtë drejtim.



OBJEKTIVAT DHE TREGUESIT E ARRITJES

OBJEKTIVI 1

Të sigurojë baza të dhënash për përbërjen e mbeturinave në qytetet Tiranë, Durrës, Shkodër, Lezhë, Lushnjë, Berat, Fushë-Krujë, Vorë dhe Fier duke i klasifikuar sipas llojit dhe aktivitetit

Treguesit e Arritjes




- ❖ 9 procese të ndarjes së mbeturinave sipas 17 kategorive të përcaktuara janë kryer në 9 qytete për të dy sezonet, atë dimëror dhe atë veror
- ❖ 28 kampione janë mbledhur në bashkinë e Shkodrës, 20 nga zona mikse dhe 8 nga zona rezidenciale
- ❖ 30 kampione të mbledhura janë klasifikuar në bashkinë e Lezhës 14 prej të cilave nga zona mikse
- ❖ 20 kampione të mbledhura në bashkinë e Fushë Krujës, prej të cilave 10 janë klasifikuar
- ❖ 20 kampione të mbledhura, prej të cilave 10 nga zona mikse, janë klasifikuar në bashkinë e Vorës
- ❖ 60 kampione të mbledhura, 17 kampione nga zona mikse dhe 7 nga zona rezidenciale, janë klasifikuar në bashkinë e Durrësit
- ❖ 240 kampione të mbledhura, 50 kampione nga zona mikse dhe 30 kampione nga zona rezidenciale, janë klasifikuar në bashkinë e Tiranës
- ❖ 20 kampione të mbledhura, 8 kampione nga zona mikse dhe 4 kampione nga zona rezidenciale, janë klasifikuar në bashkinë e Lushnjës
- ❖ 30 kampione të mbledhura, 10 kampione nga zona mikse dhe 4 kampione nga zona rezidenciale, janë klasifikuar në bashkinë e Fierit
- ❖ 30 kampione të mbledhura, 10 kampione nga zona mikse dhe 4 kampione nga zona rezidenciale, janë klasifikuar në bashkinë e Beratit
- ❖ 1 vlerësim parësor është kryer dhe 1 metodologji pune është hartuar

OBJEKTIVI 2

To provide recommendations for improvement of waste collection system

Treguesit e Arritjes

- ❖ 2 kategori trajnimesh janë ofruar për punëtorët e shërbimit të pastrimit dhe për supervizorët e Ndërmarrjes së Pastrim-Gjelbërimit në secilën njësi të qeverisjes vendore ku janë kryer proceset e ndarjes së mbeturinave: 1 trajnim në praktikë gjatë punës dhe 1 trajnim në nivelin teorik, ku supervizorët dhe pjesëmarrësit u informuan në mënyrë të përgjithshme rreth menaxhimit të mbetjeve urbane në nivel bashkiak, legjisllacionit dhe aspekteve institucionale, ndarjes së mbeturinave dhe prodhimit të tyre si edhe rreth Katalogut Evropian të Mbetjeve
- ❖ 6 sesione trajnimi janë organizuar në total me punëtorët e Ndërmarrjes së Pastrim Gjelbërimit
- ❖ 1 sesion trajnimi – trajnim për trajnerë – u organizua me supervizorët
- ❖ 30 persona përfituan asistencë dhe u trajnuan, nga të cilët 27 ishin punëtorë dhe 3 supervizorë
- ❖ 1 Raport Përfundimtar Studimi për Ndarjen e Mbeturinave u përgatit dhe u dorëzua duke përfshirë rekomandimet për përmirësime të mëtejshme lidhur me sistemin e mbledhjes së mbeturinave



Reduktimi i energjisë së përdorur dhe i emetimeve të CO2 nëpërmjet partneritetit midis shoqërisë civile dhe pushtetit vendor për edukimin e popullsisë si dhe rritjes së efijencës termike në ndërtesat e banimit

Koha e Zbatimit: Shtator 2009 -Shkurt 2011

Donatori: Komisioni Evropian

Fondi: € 169,497

Zbatohet në: Bashkia e Fierit

Sektorifamiljarështënjëngakonsumatorët më të mëdhenj të burimeve të energjisë në Shqipëri. Në vitin 2005 niveli i konsumit të energjisë arriti në 27% përkundrejt 60% të kërkesës. Si një vend mesdhetar, Shqipëria nuk ka qenë asnjëherë nën efektin e temperaturave tejet ekstreme dhe kjo gjë është reflektuar historikisht me nivelin e ulët të termoizolimit të ndërtesave të banimit. Gjatë periudhës së regjimit të kaluar, në shumë qytete u ndërtuan blloqe apartamentesh me kosto të ulët duke përdorur teknikat e parafabrikimit të cilat njihen për nivel të ulët termoizolimi. Si rrjedhojë, një sasi e konsiderueshme e energjisë elektrike apo gazit të pakëtuar

përdoret për ngrohje gjatë periudhës së dimrit; kurse, gjatë verës, janë duke u instaluar gjithnjë e më shumë pajisjet e kondicionerëve me qëllim freskimin e ambienteve. Për shumë njerëz, rritja e çmimit të energjisë elektrike ka krijuar probleme serioze lidhur me mundësinë për të paguar faturën.

Për vite me radhë, bashkitë nuk kanë mundur të adresojnë çështjen e konsumit të energjisë në ndërtesat e banimit për shkak të mungesës së kompetencave dhe instrumenteve për zbatimin e ligjit. Pas viteve '90, përgjegjësia për mirëmbajtjen e banesave të ndërtuara para këtyre viteve nuk ekzistonte; kështu, shumë

apartamente iu nënshtruan procesit të privatizimit duke mos u shoqëruar me asnjë klauzolë për mirëmbajtjen e tyre të reflektuar në kontratën e blerjes. Akoma më i paktë ishte interesi i qeverisë qendrore për ndërtesat që kishin mbetur në pronësi të shtetit.

Procesi i decentralizimit u ka dhënë më shumë përgjegjësi bashkive lidhur me sektorinestrehimit. Ligji i Bashkëpronësisë në mënyrë të veçantë do t'u japë atyre të drejtën për t'iu kërkuar banorëve të blloqeve të banimit të ngrenë këshilla qytetarë me përgjegjësinë e mirëmbajtjes së banesave. Në këtë mënyrë, ky ligj është një mjet i fuqishëm në duart e bashkive






për të ndërhyrë në çështjet e efijencës së energjisë për sektorin e strehimit, pavarësisht se ato nuk zotërojnë ende eksperiencën e nevojshme për zbatimin e këtij ligji. Mungesa e furnizimit me energji elektrike dhe pamundësia për të përballuar pagesën e saj është kthyer në një çështje serioze e cila shoqërohet me rritje të ndjeshme të kostos së elektricitetit dhe lëndëve djegëse. Kështu, pra, është e nevojshme një ndërhyrje tek familjet me të ardhura të ulëta për të shmangur përkeqësimin e gjendjes së tyre ekonomike. Projekti “Reduktimi i energjisë së përdorur dhe emetimeve të CO₂ nëpërmjet partneritetit midis

shoqërisë civile dhe pushtetit vendor për edukimin e popullsisë dhe rritjes së efijencës termike në ndërtesat e banimit”, është një nga nismat e fundit që Co-PLAN ka ndërmarrë në këtë kuadër. Ky projekt synon të ndërtojë një partneritet midis shoqërisë civile dhe pushtetit vendor (bashkisë së Fierit) për të rritur ndërgjegjësimin mbi mundësitë e reduktimit të kostove nëpërmjet rritjes së efijencës termike, duke vënë në përdorim kompetencat e bashkisë të cilat burojnë nga Ligji i Bashkëpronësisë. Kjo do të arrihet nëpërmjet rritjes së kapaciteteve të bashkisë për zbatimin e ligjit në praktikë dhe do të shoqërohet

me trajnim dhe edukim të përgjithshëm, duke përdorur si model një skemë pilot për përmirësimin e efijencës termike në një ndërtesë banimi ku jetojnë familje në nevojë. Këto familje do të përfitojnë një cilësi më të lartë jetese si dhe kosto më të ulëta të lëndëve djegëse. Përfitimet do të manifestohen në një publik më të gjerë nëpërmjet ekspozitave, seminareve dhe workshop-eve që do të organizohen. Një aksion pilot për parandalimin e degradimit mjedisor të shkaktuar nga inefijenca e përdorimit të energjisë në banesa do të testohet nëpërmjet mekanizmave me pjesëmarrje dhe atyre për rritjen e ndërgjegjësimin.





OBJEKTIVAT DHE TREGUESIT E ARRITJES

OBJEKTIVI 1

Të rrisë kapacitetet e pushtetit vendor në bashkinë e Fierit lidhur me administrimin e efijencës së energjisë në ndërtesat ekzistuese të banimit, duke vënë theksin veçanërisht në përmirësimin e termoizolimit nëpërmjet harmonizimit me Ligjin e ri të Bashkëpronësisë

Treguesit e Arritjes	- Një veprimtari publike u organizua në bashkinë Fier, me pjesëmarrjen e MPPTT, Ambasadës së Mbretërisë së Vendeve të Ulëta, zyrtarëve të lartë të bashkisë, këshillit vendor dhe organizatave të interesuara të shoqërisë civile të cilat operojnë në zonë për lançimin e projektit - Një Marrëveshje Bashkëpunimi u nënshkrua nga tri palët partnere në projekt, përkatësisht bashkia Fier, MPPTT dhe Co-PLAN - Një grup pune i bashkisë u ngrit për zbatimin e projektit, për të cilin është përgjegjës në nivelin vendor institucional
----------------------	--

OBJEKTIVI 2

Të ndërtojë një praktikë pilot për efijencën e energjisë në ndërtesat ekzistuese të banimit në një zonë me të ardhura të ulëta, nëpërmjet bashkëpunimit me komunitetin vendas, organizatat e shoqërisë civile dhe pushtetin vendor

Treguesit e Arritjes	1 takim u organizua me grupin e punës lidhur me realizimin e studimit bazë nëpër familje në zonën pilot me qëllim diskutimin dhe përcaktimin e kriterëve për përzgjedhjen e zonës pilot si dhe të metodologjisë që do të përdoret 1 pyetësor me bazë familjeje u hartua dhe procesi i plotësimit të tij u udhëhoq gjatë kohës së realizimit të studimit bazë 4 ndërtesa banimi me 90 familje u përfshinë në studim 90 intervista ballë për ballë u zhvilluan me banorët e zonës pilot 7 vizita në terren u kryen në qytetin e Fierit - Nisi fushata informative lidhur me ngritjen e Asamblesë së Qytetarëve dhe Ligjin e Bashkëpronësisë - Nisi mobilizimi i komunitetit për themelimin e Asamblesë së Qytetarëve
----------------------	--

OBJEKTIVI 3

Të rrisë ndërgjegjësimin, në qytetin e Fierit dhe më gjerë, lidhur me përfitimet që vijnë si rezultat i efijencës së energjisë, pra i reduktimit të emetimeve të CO₂ dhe përmirësimit të cilësisë së jetës në lagjet e qytetit

Treguesit e Arritjes	- Përgatitja dhe shpërndarja e 100 fletëve informuese në zonën pilot mbi përfitimet që vijnë si rezultat i efijencës së energjisë për një studim të mëtejshëm të mundësive - Organizimi i Aktivitetit të Lançimit të Projektit me pjesëmarrjen e 100 përfaqësuesve të qeverisjes qendrore dhe asaj vendore, këshillave vendorë dhe organizatave të shoqërisë civile
----------------------	--

LOGIN - Rrjeti i informacionit mbi qeverisjen vendore (viti I)

Koha e Zbatimit: 1 Shtator 2008 - 31 Gusht 2009

Donatori: LGI & Instituti për një shoqëri të hapur, Budapest

Fondi: \$ 37,000

Zbatohet në: Shqipëri

Qëllimi i LOGIN - Rrjeti i informacionit mbi qeverisjen vendore konsiston në promovimin e zhvillimit profesional të specialistëve të pushtetit vendor si dhe në forcimin e kapaciteteve të organizatave që mbështesin reformat në administratën publike në nivel vendor. Ky projekt zbatohet njëkohësisht në 15 vende ish-komuniste të Evropës Lindore dhe Qendrore të cilat i janë dedikuar krijimit të platformës së njohurive LOGIN e cila ofron informacion mbi çështje të qeverisjes vendore. Ndër të tjera, kjo

bazë të dhënash përmban të reja në lidhje me zhvillimet e procesit të integritetit të Shqipërisë në Bashkimin Evropian duke u fokusuar në urdhëresat që duhen zbatuar si edhe në mundësitë e shfaqura. Në harkun kohor Janar-Gusht 2009 është bërë i mundur konsultimi i bazës së të dhënave LOGIN në faqen zyrtare të Co-PLAN (www.co-plan.org) dhe të partnerëve të tij për të tetë modulet: legjislacioni, libraria, mundësi financimi, trajnime, integrimi evropian, kalendari, të reja dhe website të tjera. Gjatë kësaj

periudhe, në platformë janë vendosur 318 dokumente dhe materiale që kanë si qëllim përditësimin me informacion dhe zhvillime të fushës për punonjësit e administratës vendore. Numri i shkarkimeve ka arritur shifrën 15.914 gjatë vitit të parë të zbatimit të projektit. Shoqata e Bashkive të Shqipërisë, Shoqata e Komunave të Shqipërisë dhe Universiteti POLIS janë partnerët e Co-PLAN në funksionimin sa më efikas dhe pasurimin e vazhdueshëm të kësaj platforme.



OBJEKTIVAT DHE TREGUESIT E ARRITJES

OBJEKTIVI 1

Të krijohet një platformë për ndarjen e informacionit mbi reformën e administratës publike dhe zhvillimin profesional të punonjësve të administratës vendore në fushat kryesore të qeverisjes vendore

Treguesit e Arritjes	❖ Platforma e njohurive LOGIN, pas bërjes operative në faqen e internetit të Co-PLAN (www.co-plan.org), tashmë është aktive dhe funksionale edhe në faqet elektronike të partnerëve të tij, Shoqatës së Bashkive të Shqipërisë (www.aam-al.com), Universitetit POLIS (www.universitetipolis.edu.al) dhe Shoqatës së Komunave të Shqipërisë (www.aac@abcom.al); ❖ Libraria Dixhitale LOGIN tashmë është operative në tetë module që mbulojnë aspektet kryesore të qeverisjes vendore dhe të reformës në administratën publike; ❖ 318 dokumente, raporte dhe informacione janë hedhur në tetë modulet e kësaj platforme dhe janë të aksesueshme për të gjithë përdoruesit; ❖ Dokumentet e vendosura në platformën LOGIN në Shqipëri kanë arritur në rreth 15.914 shkarkime gjatë periudhës Janar-Gusht 2009.
----------------------	--

OBJEKTIVI 2

Të krijohet një rrjet partnerësh për ndarjen e informacionit dhe eksperiencave lidhur me qeverisjen vendore dhe zhvillimin e kapaciteteve lokale

Treguesit e Arritjes	❖ Në kuadër të këtij projekti, Co-PLAN ka hartuar dhe nënshkruar Marrëveshje Bashkëpunimi mbi pasurimin e platformës me materiale dhe përgatitjen e aktiviteteve të përbashkëta me donatorë e organizata partnere që operojnë në këtë fushë. Ndër to mund të përmendim Ministrinë e Integrimit Evropian, Ministrinë e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave, Komisionin Evropian, Bankën Botërore, USAID, UNDP, AAC – Albanian Association of Commune etj.
----------------------	--

OBJEKTIVI 3

Të promovohet LOGIN si një platformë njohurish mbi çështje të pushtetit vendor dhe mbi reformën në administratën publike

Treguesit e Arritjes	❖ Përgatitja dhe botimi i dy artikujve dhe një shtojce në Gazetën e Bashkive të Shqipërisë si dhe i një artikulli në Gazetën e Komunave të Shqipërisë mbi bazën e të dhënave LOGIN, qëllimin dhe funksionalitetin e saj; ❖ Organizimi i Aktivitetit për Lançimin e projektit në 29 Prill 2009, përgjatë një seminari të organizuar nga SHBSH dhe Co-PLAN; ❖ Përgatitja e broshurave dhe CD-ve me materialet e hedhura deri në këtë periudhë në website dhe shpërndarja tyre në të 385 njësitë vendore të Shqipërisë (65 bashki, 308 komuna dhe 12 qarqe); ❖ Organizimi i aktivitetit përmbyllës të vitit të parë të LOGIN, më datë 24 Korrik 2009, me temë Qeverisjen e Mirë Urbane. Në këtë aktivitet morën pjesë përfaqësues të qeverisjes qendrore dhe vendore, OJF vendase dhe të huaja, organizata ndërkombëtare, ekspertë të fushës, studentë etj.
----------------------	---

14 LOGIN - Rrjeti i informacionit mbi qeverisjen vendore (viti II)

Koha e Zbatimit: 1 Nëntor 2009 – 31 Tetor 2010

Donatori: LGI & Instituti për një shoqëri të hapur, Budapest

Fondi: \$ 29,630

Zbatohet në: Shqipëri

Qëllimi i LOGIN – Rrjeti i informacionit mbi qeverisjen vendore konsiston në promovimin e zhvillimit profesional të specialistëve të pushtetit vendor si edhe në forcimin e kapaciteteve të organizatave që mbështesin reformat në administratën publike në nivel vendor. Ky projekt zbatohet njëkohësisht në 15 vende ish-komuniste të Evropës Lindore dhe Qendrore të cilat i janë dedikuar krijimit të platformës së njohurive LOGIN e cila ofron informacion mbi çështje të

qeverisjes vendore. Ndër të tjera, kjo bazë të dhënash përmban të reja në lidhje me zhvillimet e procesit të integritetit të Shqipërisë në Bashkimin Evropian duke u fokusuar në urdhëresat që duhen zbatuar si dhe në mundësitë e shfaqura. Në harkun kohor Nëntor-Dhjetor 2009 është bërë e mundur hedhja në platformë e 143 dokumenteve dhe materialeve mbi të tetë modulet ekzistuese: legjisllacioni, libraria, mundësi financimi, trajnime, integrimi evropian, kalendari, të reja dhe website të

tjera. Gjatë kësaj periudhe gati dymujore ka vazhduar procesi i nënshkrimit të marrëveshjeve të bashkëpunimit me organizata partnere. Shoqata e Bashkive të Shqipërisë, Shoqata e Komunave të Shqipërisë dhe Universiteti POLIS do të vazhdojnë të jenë partnerë të Co-PLAN në mundësimin dhe funksionimin sa më efikas si dhe në pasurimin e vazhdueshëm të kësaj platforme.



OBJEKTIVAT DHE TREGUESIT E ARRITJES

OBJEKTIVI 1

Pasurimi sistematik i platformës për ndarjen e informacionit mbi reformën e administratës publike dhe zhvillimin profesional të punonjësve të administratës vendore në fushat kryesore të qeverisjes vendore

Treguesit e Arritjes	❖ Platforma tashmë është operative në tetë module që mbulojnë aspektet kryesore të qeverisjes vendore dhe të reformës në administratën publike; ❖ Libraria Dixhitale LOGIN mund të aksesohet nga të gjithë në faqet e internetit të Co-PLAN (www.co-plan.org), Shoqatës së Bashkive të Shqipërisë (www.aam-al.com), Universitetit POLIS (www.universitetipolis.edu.al) dhe Shoqatës së Komunave të Shqipërisë (www.aac@abcom.al); ❖ 143 dokumente, raporte dhe informacione janë hedhur në tetë modulet e kësaj platforme dhe janë të aksesueshme nga të gjithë përdoruesit; ❖ Dokumentet e vendosura në librarinë dixhitale LOGIN në Shqipëri arritën mbi 5000 shkarkime në dy muajt e fundit.
----------------------	---

OBJEKTIVI 2

Shtimi i rrjetit të partnerëve për ndarjen e informacionit dhe eksperiencave lidhur me qeverisjen vendore dhe zhvillimin e kapaciteteve lokale

Treguesit e Arritjes	❖ Marrëveshje Bashkëpunimi për pasurimin e platformës me materiale dhe përgatitjen e aktiviteteve të përbashkëta vazhdojnë të nënshkruhen ndërmjet Co-PLAN dhe organizatave kombëtare dhe ndërkombëtare që punojnë në këtë fushë.
----------------------	---

OBJEKTIVI 3

Të promovohet LOGIN si një platformë njohurish mbi çështje të pushtetit vendor dhe mbi reformën në administratën publike

Treguesit e Arritjes	❖ Përgatitja dhe botimi i tre artikujve – dy në Gazetën e Bashkive të Shqipërisë dhe një në Gazetën e Komunave të Shqipërisë – mbi bazën e të dhënave LOGIN, qëllimin dhe funksionalitetin e saj; ❖ Shpërndarja e herëpashershme e broshurave dhe e materialeve elektronike CD/DVD me informacionet e hedhura deri më tani në platformë; ❖ Bashkëpunimi në organizimin e aktiviteteve të ndryshme të të gjithë partnerëve të kësaj platforme me fokus në çështjet e pushtetit vendor dhe reformën në administratën publike.
----------------------	---

Vlerësimi bazë dhe kryerja e analizës për Kompetencat e Administratës Publike dhe Qeverisjes Vendore si dhe për Mjedisin e Zhvillimit të Kapaciteteve Vendore

Koha e Zbatimit: 18 Qershor 2009 - 31 Tetor 2009

Donatori: Organizata Holandeze për Zhvillim - SNV Shqipëri

Fondi: € 24,000


Zbatohet në: Qarku Dibër, Qarku Shkodër, Qarku Kukës, Qarku Fier, Qarku Korçë, Qarku Lezhë, Qarku Tiranë

Ky studim bazë i tregut është ndërmarrë në kuadër të punës së SNV Shqipëri duke mbajtur në konsideratë strategjinë e saj globale e cila ka në fokus ambicien e përbashkët për të ndihmuar sistematikisht në fuqizimin brenda vendit të aftësisë për zhvillimin e kapaciteteve për të arritur rezultate. Në përputhje me këtë, SNV Shqipëri, duke mbajtur në konsideratë strategjinë e saj globale, është në procesin e zhvillimit të një kanali të ri të shpërndarjes së shërbimeve të titulluar Lehtësi/Aftësi e Zhvillimit të Kapaciteteve

Vendore që synon të jetë i pavarur por edhe plotësues kundrejt shërbimeve këshillimore të SNV.

Në këtë kuadër, SNV Shqipëri ka kontraktuar Co-PLAN me qëllim kryerjen e një vëzhgimi të hollësishëm dhe gjithëpërfshirës mbi proceset e kërkesës dhe ofertës për ngritjen e kapaciteteve si pjesë e fazës së pikënisjes së një qasjeje të re e cila do të mbështesë zhvillimin ekonomik dhe social në Shqipëri. Kështu, Co-PLAN ka ndërmarrë këtë vëzhgim bazë të tregut me qëllim

vlerësimin dhe identifikimin e gjendjes aktuale të shërbimeve profesionale dhe gjysmëprofesionale të kërkesës dhe ofertës në qeverisjen vendore dhe administratën publike si edhe të mjedisit të zhvillimit të kapaciteteve, duke mundësuar një analizë të tregut lidhur me komponentësi aktorët dhe përmasat, rritja dhe zhvillimi, produktet dhe shërbimet, mjedisi mundësues/lehtësues, tendencat kryesore si edhe faktorët kyç të suksesit si për klientët/konsumatorët ashtu dhe për furnizuesit e këtyre shërbimeve.



OBJEKTIVAT DHE TREGUESIT E ARRITJES

OBJEKTIVI 1

Të mundësojë të kuptuarit e hollësishëm të situatës aktuale të kapaciteteve brenda sektorit të shërbimit të administratës publike dhe qeverisjes vendore

Treguesit e Arritjes

- ❖ 125 pyetësorë u administruan në terren, të cilët përfshinin pyetje të hapura dhe të mbyllura për të matur gjykimet e ofruesve të shërbimeve dhe të qeverisjes vendore mbi gjendjen ekzistuese të zhvillimit të kapaciteteve
- ❖ 125 intervista u realizuan në total me 75 ofrues dhe 50 klientë/konsumatorë të shërbimeve për ngritjen e kapaciteteve vendore
- ❖ 7 Qarqe të Shqipërisë u përfshinë në këtë analizë të vëzhgimit të tregut në fushën e ngritjes së kapaciteteve vendore
- ❖ 125 hedhje të dhënash mbi lehtësimin e ngritjes së kapaciteteve të qeverisjes vendore u përpunuan dhe analizuan
- ❖ Një studim në zyrë u realizua për të mundësuar shtimin e të dhënave mbi kanalet e financimit dhe përmasat e tregut për zhvillimin e kapaciteteve

OBJEKTIVI 2

Të vlerësojë situatën aktuale të ofertës dhe kërkesës për shërbimet e ngritjes së kapaciteteve në sektorin e qeverisjes vendore dhe administratës publike si dhe të mjedisit përkatës të zhvillimit të këtyre kapaciteteve

Treguesit e Arritjes


- ❖ 1 raport përfundimtar për secilin komponent u përgatit, duke përfshirë indikatorët bazë të vëzhgimit mbi tregun e zhvillimit të kapaciteteve vendore në Shqipëri si për ofruesit e shërbimeve ashtu dhe për klientët/konsumatorët e tyre në nivel vendor

OBJEKTIVI 3


Të shërbejë si pikënisje për marrjen e informacionit për ofruesit e shërbimeve në fushën e ngritjes së kapaciteteve

Treguesit e Arritjes


- ❖ Një listë me 75 ofrues shërbimesh në fushën e ngritjes së kapaciteteve vendore u mundësua për të pasuruar bazën e të dhënave ekzistuese




Do you think consultancy market is



What factors impact you as local provider of CB services to clients/users?



Q6. Which are the main sources of payment



Hartimi i Planit të Menaxhimit të Mbetjeve Urbane në komunën Guri i Zi

Koha e Zbatimit: Dhjetor 2008 - Prill 2009

Donatori: DLDP, financuar nga InterCooperation në Shqipëri

Fondi: € 13, 300

Zbatohet në: Komuna e Gurit të Zi

Komuna e Gurit të Zi është mbështetur që prej vitit 2006 nga InterCooperation në Shqipëri për hartimin e Planit Strategjik të Zhvillimit nëpërmjet asistencës së Co-PLAN (Instituti për Zhvillimin e Habitatit). Në kuadër të objektivave të parashikuara në Planin Strategjik të Zhvillimit, komuna hartoi Planin e Menaxhimit të Mbetjeve Urbane në vijimësi me qëllim plotësimin e nevojave të komunës në lidhje me përmirësimin e shërbimit të pastrimit në zonë.

Nevoja për të përgatitur një plan menaxhimi ka ardhur si pasojë e një mungese të gjatë

të shërbimit të pastrimit për komunitetin vendas, gjë e cila ka çuar në përkeqësimin e kushteve mjedisore, në ndotjen e vazhduar të tij si dhe në rritjen e shanseve për përkeqësimin e higjienës dhe shëndetit publik dhe individual.

Në këtë kontekst, komuna, me mbështetjen e InterCooperation në Shqipëri dhe asistencën e Co-PLAN (Instituti për Zhvillimin e Habitatit), ndërmori nismën për përgatitjen e një plani për menaxhimin e mbetjeve urbane nëpërmjet proceseve me pjesëmarrje, të cilat përfshinë komunitetin vendas, stafin e administratës vendore si

dhe grupet e interesit. Përgatitja e planit u bazua në gjetjet e një studimi të vlerësimit paraprak mjedisor i cili ka përfunduar në Tetor 2008.

Qëllimi kryesor i këtij projekti konsistoi në pajisjen e komunës së Gurit të Zi me Planin e Menaxhimit të Mbetjeve Urbane, i cili do të përmirësojë situatën mjedisore dhe gjendjen shëndetësore të popullatës vendase nëpërmjet zhvillimit të instrumenteve të nevojshëm për përmirësimin e cilësisë së kushteve të jetesës për banorët e komunës së Gurit të Zi lidhur me mjedisin urban në të cilin ata jetojnë dhe shëndetin e tyre.



OBJEKTIVAT DHE TREGUESIT E ARRITJES

OBJEKTIVI 1

Sigurimi i një skeme efektive për menaxhimin e mbetjeve për 7 fshatrat e komunës së Gurit të Zi

Treguesit
e Arritjes

- ❖ 3 skema të mundshme për zbatim mbi menaxhimin e mbetjeve urbane u hartuan në bashkëpunim me grupin e punës së komunës dhe u prezantuan për diskutim dhe miratim në këshillin vendor të saj
- ❖ 9 harta tematike për mbetjet urbane u përgatitën dhe iu dorëzuan komunës së Gurit të Zi
- ❖ 1 Plan i Menaxhimit të Mbetjeve Urbane u hartua për komunën e Gurit të Zi dhe u miratua në këshillin vendor
- ❖ 50 kopje të Planit për Menaxhimin e Mbetjeve Urbane u publikuan dhe u shpërndanë tek aktorët e interesuar

OBJEKTIVI 2

Finalizimi i përlogaritjes së kostove të shërbimit nëpërmjet identifikimit të një analize efektive të kostos dhe përfitimit lidhur me secilën skemë alternative të propozuar dhe përgatitja e vlerësimit të kostos së ndërhyrjeve për përmirësimin e situatës ekzistuese

Treguesit
e Arritjes

- ❖ 3 skenarë financiarë për secilën skemë të mundshme për zbatim janë përgatitur në bashkëpunim me grupin e punës së komunës
- ❖ 1 dokument i analizës së kostos dhe përfitimit u hartua

OBJEKTIVI 3

Fuqizimi i kapaciteteve organizative dhe burimeve njerëzore të komunës së Gurit të Zi lidhur me efektivitetin e procesit të menaxhimit të mbetjeve urbane

Treguesit
e Arritjes

- ❖ 1 grup pune u ngrit dhe u asistua për përgatitjen e PMMU
- ❖ Një seri takimesh konsultative u zhvilluan dhe u ofrua asistencë në punë për grupin e punës dhe Ndërmarrjen e Pastrim-Gjelbërimit
- ❖ 1 strukturë e re organizative brenda administratës së komunës Guri i Zi lidhur me menaxhimin e mbetjeve urbane u propozua për miratim

OBJEKTIVI 4

Mobilizimi i komunitetit vendas në proceset me pjesëmarrje për vendimmarrjen lidhur me planifikimin dhe përgatitjen e dokumentit “Plani i Menaxhimit të Mbetjeve Urbane”

Treguesit
e Arritjes

- ❖ 1 grup me përfaqësues të qytetarëve u ngrit në komunën e Gurit të Zi, me pjesëmarrjen e komunitetit vendas, shkollave, bizneseve dhe qendrave shëndetësore të zonës
- ❖ 3 takime janë realizuar me grupin e përfaqësuesve të qytetarëve për hartimin e PMMU në komunën e tyre. Qëllimi specifik i takimeve ishte identifikimi i prioriteteve të banorëve dhe adresimi i tyre në këtë plan si dhe diskutimi i skenarëve të mundshëm për të arritur në miratimin përfundimtar

Vlerësimi i ecurisë së zbatimit të Planit për Menaxhimin e Mbetjeve Urbane në bashkinë e Fushë-Arrëzit

Koha e Zbatimit: Shkurt - Mars 2009

Donatori: InterCooperation në Shqipëri

Fondi: € 2973

Zbatohet në: Bashkia e Fushë-Arrëzit

Bashkia e Fushë-Arrëzit është një nga gjashtë njësitë e qeverisjes vendore në Rajonin e Shkodrës të cilat janë pjesë e Programit për Decentralizimin dhe Zhvillimin Vendor (DLDP) që zbatohet dhe financohet nga InterCooperation në Shqipëri.


Gjatë vitit 2007, u përgatit Plan i Menaxhimit të Mbetjeve Urbane për qytetin dhe fshatin në bashkinë e Fushë-Arrëzit, i cili u miratua më pas në këshillin vendor të kësaj bashkie. Që prej vitit 2008, bashkia u përfshi në procesin e përgatitjes së Planit Strategjik të Zhvillimit, një dokument i cili identifikoi Planin e Menaxhimit të Mbetjeve Urbane si një kusht institucional për sigurimin e investimeve në të tashmen dhe të ardhmen lidhur me shërbimin e

menaxhimit të mbetjeve urbane në Fushë-Arrëz.

Në këtë kuadër, PMMU gjeti zbatim që prej fillimit të vitit 2008 dhe u ndoq nga realizimi i investimeve në infrastrukturën fizike të menaxhimit të mbetjeve, nëpërmjet mbështetjes financiare të DLDP. InterCooperation në Shqipëri është e interesuar të vlerësojë ecurinë e zbatimit të PMMU në bashkinë Fushë-Arrëz si dhe të ofrojë rekomandime për të ardhmen.

Ky vlerësim do të fokusohet në monitorimin e indikatorëve dhe rekomandimeve të paraqitura në planin e menaxhimit të mbetjeve urbane dhe do të analizojë eficiencën e ofrimit të shërbimit, raportin mes mbledhjes së taksave dhe kostove të shërbimit, opinionin e qytetarëve lidhur me

performancën e shërbimit dhe impaktin e tij dhe masat e marra për mundësimin e një studimi fizibiliteti për vendin e depozitimit të mbetjeve në një të ardhme të afërt. Kështu, Co-PLAN u kontraktua nga InterCooperation në Shqipëri për kryerjen e një vlerësimi mbi ecurinë e zbatimit të PMMU në bashkinë Fushë-Arrëz. Qëllimi i këtij vlerësimi është të sigurojë rekomandimet e nevojshme lidhur me konsolidimin e shërbimit të pastrimit nëpërmjet përmirësimit të vazhdueshëm të mjeteve dhe instrumenteve me qëllim përmirësimin e kushteve të jetesës së banorëve vendas që lidhen me mjedisin urban në të cilin ata jetojnë dhe gjenden e tyre shëndetësore.



OBJEKTIVAT DHE TREGUESIT E ARRITJES

OBJEKTIVI 1



Të vlerësojë ecurinë e procesit të zbatimit të Planit të Menaxhimit të Mbetjeve Urbane në bashkinë e Fushë-Arrëzit

Treguesit e Arritjes	❖ Një format interviste me fokus grup u përgatit me qëllimin për të lehtësuar mbledhjen e informacionit ❖ 1 takim-intervistë u zhvillua me kryetarin e bashkisë së Fushë-Arrëzit ❖ 1 takim-intervistë u zhvillua me këshillin vendor të bashkisë së Fushë-Arrëzit ❖ Një takim vlerësues u organizua me Ndërmarrjen e Pastrim-Gjelbërimit të bashkisë ❖ Një takim vlerësues u organizua me grupin e përfaqësuesve të qytetarëve në qytetin Fushë-Arrëz dhe në fshatra ❖ 1 vizitë në terren u realizua në qytetin e Fushë-Arrëzit për vëzhgimin e drejtpërdrejtë të situatës mjedisore lidhur me mbetjet urbane, të punës për zbatimin e skemës së miratuar sipas planit dhe të kushteve fizike të mjeteve përkatëse
----------------------	---

OBJEKTIVI 2

Të sigurojë rekomandimet e nevojshme për hapat që duhen hedhur drejt konsolidimit të shërbimit të pastrimit nëpërmjet përmirësimit të vazhdueshëm të mjeteve dhe instrumenteve me qëllim përmirësimin e kushteve të jetesës së banorëve vendas që lidhen me mjedisin urban në të cilin ata jetojnë dhe gjendjen e tyre shëndetësore

Treguesit e Arritjes	❖ Një Raport Final Vlerësimi mbi ecurinë e zbatimit të Planit për Menaxhimin e Mbetjeve Urbane në bashkinë e Fushë-Arrëzit u përgatit në gjuhët Shqip dhe Anglisht ❖ Një seri indikatorësh dhe rekomandimesh u paraqitën në raportin final, lidhur me hapat që duhen ndërmarrë në vijim për përmirësimin e ofrimit të shërbimit të pastrimit në të ardhmen
----------------------	---



Plani i Menaxhimit të Mbetjeve Urbane në Komunën e Dajçit

Koha e Zbatimit: Shtator 2009 - Dhjetor 2009

Donatori: Inter-cooperation

Fondi: € 13,200

Zbatohet në: Komuna e Dajçit

Në përputhje me prioritetet dhe objektivat e përcaktuara nga Plani i Zhvillimit Strategjik, Komuna e Dajçit ka përcaktuar nevojën për ofrimin dhe organizimin e shërbimit të administrimit të mbetjeve të ngurta urbane brenda territorit të komunës.

Që në Shtator 2009, Komuna e Dajçit, me mbështetjen e Inter-cooperation dhe me asistencën e Co-PLAN, është angazhuar në zhvillimin e projektit për Planin e Menaxhimit të Mbetjeve të ngurta urbane, i cili në mënyrë strategjike do të mundësojë



organizimin e shërbimit të largimit të mbetjeve dhe përmirësimin e gjendjes mjedisore dhe standardeve të jetesës brenda komunës.

Projekti zbatohet në Komunën e Dajçit. Qëllimi i projektit është përmirësimi i shërbimit të largimit të mbetjeve me anë të zhvillimit të mjeteve dhe instrumenteve të nevojshme, për të ngritur standardet e jetesës të komunitetit lokal në lidhje me mjedisin urban dhe shëndetin.

Për të arritur objektivat e projektit, u ndoqën metodologjia dhe aktivitetet

e planifikuara dhe u përfshinë në proces edhe komponentë të vlerësimit organizativ, teknik dhe financiar.

Metodologjia vijoi me fillimin e procesit me pjesëmarrje dhe përfshirjen e bashkëpunëtorëve; vlerësimin e situatës aktuale; identifikimin e skemave të mundshme të menaxhimit të mbetjeve; llogaritjen e koston dhe skenarët e mbulimit të koston; diskutime dhe vlerësime; zhvillimin e planit final të menaxhimit të mbetjeve dhe hartimin e planit dhe të dokumenteve mbështetës.



OBJEKTIVAT DHE TREGUESIT E ARRITJES

OBJEKTIVI 1


Vlerësimi i gjendjes ekzistuese

Treguesit e Arritjes	❖ 2 takime u mbajtën me grupin e punës për fillimin e procesit me pjesëmarrje dhe mbledhjen e informacionit të nevojshëm (të përgjithshëm dhe teknik); për shqyrtimin e organizimit të stafit të komunës, strukturës ligjore dhe akteve e rregulloreve lokale; për identifikimin e administrimit financiar etj. ❖ Një vizitë u krye në terren për të monitoruar gjendjen aktuale dhe për të parë mundësinë e zhvillimit të skemave të ardhshme të mbledhjes së mbetjeve.
----------------------	---

OBJEKTIVI 2

Të sigurojë një skemë efektive për menaxhimin e mbetjeve të ngurta urbane dhe përzgjedhjen e skenarit më të mirë për shërbimin e largimit të mbetjeve; të finalizojë llogaritjen e koston së plotë të shërbimit dhe opsionet për mbulimin e koston referuar skenarëve të përzgjedhur

Treguesit e Arritjes	❖ 1 takim me grupin e punës u mbajt për të zhvilluar dhe diskutuar skenarët ❖ 1 takim për vlerësimin e skenarëve të mundshëm u organizua, me pjesëmarrjen e stafit të komunës dhe të ekspertit të SDC, ku u përzgjodh skema më e mirë. ❖ Stafi i Komunës u asistua në vlerësimin dhe realizimin e analizës së koston dhe të tarifës. ❖ U përcaktua niveli i tarifave për kategoritë përfituese. ❖ Një analizë e plotë për llogaritjen e koston dhe të mbulimit të koston iu ofrua grupit të punës për të gjithë skenarët duke përfshirë metodologjinë e plotë, tabelat llogaritëse, hartat dhe raportet.
----------------------	--





OBJEKTIVI 3

Të zhvillojë dhe finalizojë një plan për menaxhimin e mbetjeve dhe të sigurojë dokumentet e nevojshëm për zbatimin e tij

Treguesit e Arritjes	❖ Zhvillimi i një plani për administrimin e mbetjeve dhe nxjerrja e konkluzioneve dhe rekomandimeve për secilin aspekt si: ❖ Institucional dhe rregullator, ku përfshihet struktura organizative për menaxhimin e mbetjeve të ngurta urbane, rregulloret komunale dhe mjetet për administrimin e mbetjeve, partneritetet e mundshme institucionale dhe veprimet e koordinuara. ❖ Operacional dhe teknik, ku përfshihen rekomandime për përmirësimin e skemës së propozuar, identifikimin e promovimit të iniciativave të riciklimit, praktikat e kompostimit dhe trajtimin e depozitimin e mbetjeve. ❖ Plani për financimin e skemës, identifikimin e burimeve financiare dhe përfitimeve ekonomike, mbulimin e kostos në një periudhë afatshkurtër dhe afatgjatë, masat e propozuara për përmirësimin e strukturës së tarifës në arritjen e stabilitetit financiar. ❖ Plani për edukimin ambientel dhe partneriteti publik-privat. ❖ Plani për monitorimin dhe vlerësimin e skemës së propozuar. ❖ Plan-Vepri 2010-2014 për zbatimin e PMMNU (si aneks i planit, në anglisht dhe shqip) ❖ Një raport mbi anën legale e rregullatore dhe kuadrin organizativ për administrimin e mbetjeve në komunën Dajç (si aneks i planit).
----------------------	---

OBJEKTIVI 4

Të realizojë ngritjen e kapaciteteve të grupit të punës së komunës me anë të zhvillimit të planit si dhe duke realizuar pjesëmarrjen e tyre dhe ndjekjen e zbatimit të PMMNU në Gurin e Zi

Treguesit e Arritjes	❖ Në të gjitha takimet e zhvilluara me grupin e punës, stafi i komunës u pajis me njohuri dhe asistencë praktike lidhur me mënyrën me të cilën duhet proceduar me procesin e planifikimit dhe me zbatimin e planit të menaxhimit të mbetjeve. ❖ Stafi i komunës së Dajçit mori gjithashtu pjesë në takimet mbi zbatimin e planit të menaxhimit të mbetjeve ngurta urbane në komunën e Gurit të Zi.
----------------------	---

Asistencë teknike në vazhdim për zbatimin e Planit të Administrimit të Mbetjeve Urbane në Komunën e Gurit të Zi

Koha e Zbatimit: Shtator 2009 - Dhjetor 2009

Donatori: Inter-cooperation

Fondi: € 11,525

Zbatohet në: Komuna e Gurit të Zi

Plani i aprovuar për menaxhimin e mbetjeve të ngurta (PMMN) për komunën e Gurit të Zi mundësoi planifikimin dhe rregullat për një skemë operationale dhe efektive për mbledhjen e mbeturinave në përputhje me kapacitetet e komunës si dhe në përfitimin maksimal të komunitetit. Komuna kërkoi asistencë teknike shtesë për zbatimin e planit si dhe për përgatitjen e dokumentacionit mbështetës për zbatim. Sipas zhvillimeve që pasuan, pas miratimit të planit, komuna zgjodhi skenarin e parë si alternativën më të mirë për parashikimin e shërbimit duke përdorur një makinë teknologjike dhe kontejnerë të rinj për mbledhjen e mbeturinave si dhe

përdorimin e vend-depozitimit aktual të Shkodrës si vend-depozitim final.




Sipas skenarit të përzgjedhur, një shërbim i mbledhjes së mbeturinave do të ofrohet në zonën pilot dhe do të përfshijë të gjitha kategoritë e konsumatorëve për fshatrat kryesorë Guri i Zi, Juban, Vukatanë dhe Rrenc sikurse edhe një shërbim i grumbullimi të mbetjeve vetëm për bizneset dhe institucionet në fshatrat e tjerë si Rragam, Ganjoll e Gajtan.

Zbatimi i projektit do të bëhet në komunën e Gurit të Zi.

Bazuar në rekomandimet e planit të administrimit të mbetjeve të ngurta dhe në nevojat e prezantuara nga komuna për

zbatimin e skemës pilot, qëllimi i projektit konsiston në mundësimin e autoriteteve lokale që të zbatojnë në praktikë një shërbim efektiv dhe eficient në kushtet e komunës.

Metodologjia e projektit vijoi me procesin e mobilizimit të grupit ekzistues të punës, krijuar gjatë zhvillimit të PMMN, dhe vazhdoi më tej me vlerësimin dhe rishikimin e skemës së mbledhjes së mbetjeve dhe përmirësimin e saj, llogaritjen e koston dhe të buxhetit, përcaktimin e sistemit të mbulimit të koston, hartimin e dokumenteve mbështetës dhe asistencën teknike deri në përmbushjen me sukses të zbatimit të menaxhimit të mbetjeve.



OBJEKTIVAT DHE TREGUESIT E ARRITJES

OBJEKTIVI 1

Të asistojë komunën në përmirësimin e skemës së përzgjedhur për mbledhjen e mbeturinave, në llogaritjen e kostos vjetore, në planifikimin e investimeve dhe në financimin e shërbimit lidhur me zbatimin e skemës pilot të shërbimit

Treguesit e Arritjes


- ❖ 1 takim u organizua me grupin ekzistues të punës së komunës për të mbledhur informacionin e nevojshëm shtesë dhe për të krijuar mundësinë e diskutimit dhe bashkëpunimit midis këtij grupi pune dhe ekspertëve të Co-PLAN në lidhje me planifikimin, hartimin e dokumentacionit dhe aftësitë teknike që nevojiten për zbatimin e skemës pilot në komunë.
- ❖ Një vizitë në terren u krye në të gjithë fshatrat e komunës me pjesëmarrjen e grupit të punës dhe përfaqësuesve të komunitetit, për të verifikuar skemën e propozuar për mbledhjen e mbeturinave, për të verifikuar vendet e grumbullimit të mbetjeve dhe për të gjetur mundësitë për përmirësimin e mëtejshëm të tyre.
- ❖ Një skemë e përmirësuar u zhvillua duke përfshirë përcaktimin e numrit të kontejnerëve dhe të vendeve të mbledhjes së mbeturinave, itinerarin e grumbullimit, frekuencën dhe kohën e mbledhjes së mbetjeve.
- ❖ U aplikua një metodologji për llogaritjen e plotë të kostos, për të përllogaritur koston vjetore si dhe për të planifikuar investimet.
- ❖ 1 takim u mbajt për të diskutuar dhe vlerësuar skemën e përzgjedhur, planin e mbulimit të kostos si dhe nivelin e tarifave.
- ❖ Një skemë e mbulimit të kostos u hartua për të përcaktuar mënyrat e mbulimit të financimit të skemës pilot në vitin e parë dhe në vitet në vazhdim.
- ❖ U miratua zyrtarisht paketa fiskale (ku përfshihen edhe tarifat për administrimin e mbetjeve urbane) në Këshillin Komunal.

OBJEKTIVI 2

Asistencë teknike për procedurën e tenderit për blerjen e kazanëve dhe të makinës teknologjike

Treguesit e Arritjes

- ❖ U përgatitën termat e referencës, ku përfshihen specifikimet teknike të makinës teknologjike dhe të kontejnerëve dhe kritere të përgjithshme dhe specifike për ofertuesit
- ❖ Komuna organizoi tenderin për blerjen e kontejnerëve dhe makinës
- ❖ Komuna realizoi blerjen e makinës teknologjike dhe të 155 kontejnerëve.



OBJEKTIVI 3

T'i mundësojë komunës ngritjen e një strukture për menaxhimin e mbetjeve të ngurta brenda stafit të saj dhe ta mbështesë atë në hartimin e rregulloreve dhe udhëzimeve

Treguesit e Arritjes	❖ Asistenca e ofruar për: organizimin e shërbimit dhe përcaktimin e burimeve njerëzore për brigadën; përcaktimin e roleve dhe përgjegjësi të qarta; ngritjen e strukturës në nivel komunal për administrimin e mbetjeve. ❖ Miratimi i krijimit të brigadës së pastrimit brenda strukturës së re të komunës nga Këshilli Komunal. ❖ Krijimi i një rregulloreje për administrimin e mbetjeve e cila mundëson krijimin e rregullave, përcaktimin e roleve të komunës, brigadës, komunitetit, pronarëve të tokës, kompanive, detyra konkrete dhe përgjegjësi për secilin partner, masat administrative për detyrimin dhe ndëshkimin e shkeljeve. ❖ Përgatitja e Plan-Veprimit 2010-2014 si një dokument udhëzues për zbatimin e PMMN. Ky plan-veprim ka përcaktuar objektivat, aktivitetet, përgjegjësitë dhe buxhetet indikativë për secilin aktivitetet. Dokumenti përfshin masa operationale, institucionale, financiare dhe monitoruese si dhe fushatën sensibilizuese për të mundësuar zbatimin e skemës dhe përmirësimin e mëtejshëm të saj. ❖ Hartimi i formularëve të monitorimit dhe atyre të raportimit të skemës pilot.
----------------------	--

OBJEKTIVI 4

Ngritja e kapaciteteve të grupit të punës të komunës së Gurit të Zi

Treguesit e Arritjes	❖ 4 takime janë mbajtur me grupin e punës, gjatë të cilave stafit të komunës i është mundësuar rritja e njohurive dhe i është ofruar asistencë praktike në aplikimin e administrimit të mbetjeve të ngurta.
----------------------	---



